



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 284 Akti

Nr. 409 Vendimi
Tiranë, më 30.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Brunilda Bektoshi	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 25.6.2021, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kreshnik Ajazi** me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E** të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektoshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Kreshnik Ajazi me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të germës “b”, të pikës 7, të nenit 3 dhe pikës 9, të nenit 3, të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.3.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Kreshnik Ajazi, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. ***, datë 9.3.2020, bëri rishpërndarjen e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj, me short anëtar zëvendësues u caktua komisionere Xhensila Pine. Ky zëvendësim i anëtarit të trupit gjykues i është njoftuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike, i cili pasi është njohur me këtë ndryshim në datat 18.4.2020 dhe 23.4.2020, ka deklaruar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarin zëvendësues, sikurse me anëtarët e tjerë të trupit gjykues. Për shkak të kandidimit¹ të subjektit për Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, me përparësi nga Komisioni.
5. Trupi gjykues, pasi kishte administruar të tri raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 21.3.2019, kishte vendosur: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Roland Ilia. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesave me subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi.
6. Në datën 21.5.2021, anëtarja e trupit gjykues Xhensila Pine, pas njohjes me rezultatet e hetimit, kërkoi përjashtimin e saj nga procesi i rivlerësimit të z. Kreshnik Ajazi dhe trupit gjykues i shortuar² me vendimin nr. ***prot., datë 25.5.2021, vendosi pranimin e kërkesës së saj. Në datën 27.5.2021, për rrethana të ndërvarura me kërkesën e znj. Xhensila Pine, komisionerja Brunilda Bekteshi kërkoi përjashtimin³ e saj nga procesi i rivlerësimit për subjektin Kreshnik Ajazi. Trupi gjykues, i shortuar⁴ me vendimin e datës 2.6.2021, vendosi mospranimin e kërkesës së komisioneres Brunilda Bekteshi.
7. Në datën 25.5.2021, anëtari zëvendësues, komisionerja Genta Tafa (Bungo), deklaroi se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesave me subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi. Në datën 4.6.2021, po ashtu edhe subjekti i rivlerësimit deklaroi mungesën e konfliktit të interesit me

¹Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 7.1.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

²Vendimi nr. ***, datë 21.5.2021, i Komisionit.

³Referojuni kërkesës nr. *** prot., datë 27.5.2021.

⁴Vendimi nr. ***, datë 27.5.2021, i Komisionit.

komisioneren Genta Tafa (Bungo). Në datën 4.6.2021, anëtares zëvendësuese iu dërguan për njohje rezultatet e hetimit administrativ, për të cilët më 10.6.2021, shprehu dakordësinë e saj.

8. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 10.6.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht, për subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 8 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, si dhe për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Në datën 10.6.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 8 ditëve. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në mënyrë elektronike.

10. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 21.6.2021, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar në të njëjtën datë, subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 25.6.2021, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore, me subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 25.6.2021 për të rifilluar në datën 30.6.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Subjekti i rivlerësimit Kreshnik Ajazi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke

paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese⁵ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport⁶ për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur, për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se: deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në zbatim të nenit 31/1, rezulton se subjekti i rivlerësimit Kreshnik Ajazi e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 29.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Kreshnik Ajazi, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2009.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, deklaratimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; dhe (ë) analizën financiare të bërë nga Njësia e Shërbimit Ligjor e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁵Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁶ Raport me nr. ***prot., datë 7.2.2019.

Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilën nga pasuritë dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në deklaratën *Vetting*, ka rezultuar si vijon:

1. Në lidhje me llogarinë rrjedhëse në “Credins Bank”

1.1 Në këtë llogari janë kryer vetëm veprime kreditim/tërheqje page në monedhën lekë. Subjekti ka bashkëlidhur statementin e nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht, printuar nga sistemi i bankës dhe kontratën 14.1.10, për emetim kartë debiti. Gjendja aktuale në datën 24.1.2017, është në vlerën 76.28 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti ka paraqitur⁷, nxjerrje llogarie rrjedhëse page në “Credins Bank” në emër të z. Kreshnik Ajazi, për periudhën 5.1.2010 – 23.1.2017, me gjendje në vlerën 76.28 lekë.

1.2 Nga hetimi administrativ përmes korrespondencës së mbajtur me “Credins Bank”⁸, është konfirmuar se z. Kreshnik Ajazi ka llogari pranë kësaj banke dhe gjendja e llogarisë rrjedhëse në datën 24.01.2017 është në vlerën 76.28 lekë.

1.3 Trupi gjykues, pas verifikimit të deklaramit të subjektit në raport me të dhënat bankare të administruara, ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit, duke konkluduar se ka deklaruar saktë këtë llogari bankare.

2. Në lidhje me llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në monedhën lekë

2.1 Rezultoi se subjekti ka deklaruar këtë llogari me gjendje aktuale në datën 27.1.2017, 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti ka paraqitur⁹, statementin e nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht printuar nga sistemi i bankës, nxjerrje llogarie rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emër të z. Kreshnik Ajazi, për periudhën 5.11.2007 – 16.1.2017, me gjendje 0 (zero) lekë.

2.2 Trupi gjykues, lidhur me këtë llogari, konstatoi se nga dokumentacioni i “Raiffeisen Bank”¹⁰, është konfirmuar se kjo llogari rezulton në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 0 (zero) lekë. Në këto rrethana, trupi gjykues konkludon se subjekti e ka deklaruar saktë këtë llogari bankare.

3. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në monedhën lekë

3.1 Kjo llogari është hapur në datën 7.5.1997, me nr. klienti ***, në emrin e subjektit nga nëna e tij, si depozitë interesi me nr. depozite ***, në ish-Bankën e Kursimeve, Gramsh dhe mbartur në “Raiffeisen Bank”. Vlera fillestare e çeljes së llogarisë ka qenë 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Subjekti ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2015, të “Raiffeisen Bank”, statement nxjerrje llogarie, datë 18.3.2015, si dhe dy fletë kopje të librezës së vitit 1997. Gjendja është rreth 15.980 (pesëmbëdhjetë mije e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë. Pjesa takuese:100%. Subjekti ka depozituar librezën e kursimit¹¹, e cila pasqyron se kjo depozitë mban numrin *** dhe është çelur në datën 7.5.1997, në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

⁷Shihni Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸Me shkresën nr. ***prot., datë 18.12.2019.

⁹Shihni Aneksin nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019.

¹¹Shihni Aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

3.2 Nga hetimi administrativ¹², ka rezultuar se nga “Raiffeisen Bank”, konfirmohet fakti që kjo llogari depozite rezulton të jetë në emër të subjektit të rivlerësimit në shumën 16.015,15 lekë, në datën 29.1.2017 dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar.

4. Në lidhje me llogarinë depozitë në “Credins Bank”

4.1 Rezulton se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar këtë likuiditet/lloji depozitë pa afat, në monedhën euro, çelur në datën 24.10.2016. Norma e interesit me bazë vjetore 0.05%. Vlera fillestare e krijimit të llogarisë 17.500 euro. Burimi i krijimit kanë qenë të ardhurat nga kursimet për periudhën 2007 – 2016, të deklaruara më parë në ILDKPKI, si gjendje *cash*. Llogaria është hapur në zbatim të detyrimit sipas nenit 4/1 të ligjit 9049/2003, bashkëlidhur kontrata e depozitës nr. ***, datë 24.10.2016, dy fletë, një fletë nxjerrje nga llogaria në datën 24.1.17 dhe një fletë mandat i derdhjes së datës 24.10.16. Për hapjen e kësaj llogarie është pakësuar gjendja *cash* e deklaruar më parë në vlerën 2.380.000 lekë, pasi janë këmbyer në datën 24.10.2016, nga lekë në euro (kursi i këmbimit i ditës 1 euro në blerje 136 lekë). Gjendja aktuale në datën 24.1.2017 është në vlerën 17.501,38 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e një presje tridhjetë tetë) euro. Shtuar llogaria në datën 31.12.2016 me shumën 1.63 euro, si normë interesi dhe pakësuar më 31.12.16 me 0.23 tatim mbi interesin. Në total shtuar në datën 31.12.2016 me 0.00138 euro. Pjesa takuese: 100%. Subjekti ka paraqitur¹³ kontratën e depozitës pa afat me nr. ***, për individë, në “Credins Bank” në emrin e z. Kreshnik Ajazi, në euro, me shumën 17.500 euro, me datë çelje më 24.10.2016, me interes 0,05% bazë vjetore. Subjekti ka bashkëlidhur mandatpagesën, datë 24.10.2016, për shumën 17.500 euro, në “Credins Bank”, si dhe nxjerrje llogarie.

4.2 Nga hetimi rezulton se “Credins Bank”¹⁴ ka konfirmuar se z. Kreshnik Ajazi ka llogari depozite pranë kësaj banke dhe gjendja e depozitës në datën 29.1.2017 është në vlerën 17.501,38 euro.

4.2.a Kjo depozitë konfirmohet me kontratën e depozitës pa afat nr. ***, datë 24.10.2016, lidhur midis “Credins Bank” dhe shtetasit Kreshnik Ajazi. Vlera e investimit 17.500 euro. Subjekti ka depozituar shumën 17.500 euro me përshkrimin “arkëton Kreshnik Ajazi, kursime nga të ardhurat, paga dhe shpërblime, 2007-2016”.

4.3 Subjekti ka deklaruar gjendje *cash*, shtesa dhe pakësime çdo vit në deklaratat periodike vjetore, nga deklarata e parë para fillimit të detyrës në vitin 2009 deri në vitin 2016. Deklarimet e tij janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Tabela nr. 1

Viti	Përshkrimi	Vlera	Shuma akumulative
4.12.2009 (përpara fillimit të detyrës)	1. Kursime personale në të holla, i mbaj në shtëpi. Burimi: të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës (bursa) nga 3.11.2007– 3.9.2009 (500.000 lekë). 2. Dhuratë nga prindërit. Burimi i krijimit: aktivitet privat dhe puna e babait. Krijuar në tetor 2007 (200.000 lekë)	500,000 200,000	700,000
2009	Shtesë në shumën 50.000 lekë nga të ardhurat e pagës si prokuror	50,000	750,000
2010	Kursime nga paga	90,000	840,000

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019, korrespondenca e mbajtur me “Raiffeisen Bank”.

¹³Shihni Aneksin 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁴Me shkresën nr. ***prot., datë 18.12.2019.

2011	Kursime personale nga paga dhe kursime familjare	800,000	1,640,000
2012	Shtesë në kursimet personale të mbajtura <i>cash</i> në banesë mbi shumën e deklaruar në vitin pararendës	200,000	1,840,000
2013	Shtesë në kursimet personale të mbajtura <i>cash</i> në banesë mbi shumën e deklaruar në vitin pararendës	360,000	2,200,000
2014	Shtesë në kursimet personale të mbajtura <i>cash</i> . Burimi kanë qenë të ardhurat nga paga si funksionar publik	420,000	2,620,000
2015	Shtesë në kursimet personale. Burimi kanë qenë të ardhurat e specifikuar më poshtë (pagë +honorare)	510,000	3,130,000
2016	1. Pakësim në sasinë e gjendjes <i>cash</i> të kursimeve personale të deklaruara në vitet pararendëse me burim nga pagat, shpërblimet dhe të ardhurat e tjera të ligjshme për periudhën 2007 – 2015, të deklaruara në deklaratat 2009 – 2015. (2.380.000 lekë). 2. Shtesë në kursimet personale. Burimi ka qenë të ardhurat e specifikuar më poshtë (pagë+shtesa). Pas pakësimit të pikës 1 më sipër, gjendja totale e parave <i>cash</i> është 900.000 lekë ku përfshihen 750.000 lekë të mbetura në gjendje nga deklaratimet e mëparshme, si dhe 150.000 lekë kursime të vitit 2016	- 2,380,000 + 150,000	900,000

4.4 Komisioni kreu analizën financiare nga viti 2009 – 2016, duke përfshirë të ardhurat e subjektit dhe familjarëve të tij që ka pasur në certifikatën familjare, shpenzimet e identifikuar familjare, kreditë e marra dhe të shpenzuara për nevoja familjare¹⁵, si edhe gjendjen *cash* të deklaruar, nga ku nuk i rezultuan problematika.

4.5 Meqenëse subjekti ka deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës se shumë prej 200.000 lekësh i është dhuruar në vitin 2007 nga prindërit, Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë financiare të tyre për të dhuruar këtë shumë.

4.6 Në analizën e kryer janë përfshirë të ardhurat e prindërve, shpenzimet e jetesës, kreditë dhe gjithë shpenzimet e tjera të evidentuara për periudhën 2000 – 2007. Në analizë nuk janë përfshirë të ardhurat përpara kësaj periudhe, duke marrë në konsideratë faktin se në fund të vitit 1999 ka përfunduar investimi për shtëpinë e banimit në qytetin e Tiranës dhe gjithë kursimet e krijuara deri në vitin 1999 mund të jenë përdorur për ndërtimin dhe arredimin e shtëpisë.

4.7 Nga përlllogaritjet financiare të kryera, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi dukej se prindërit e tij nuk kanë pasur mundësi financiare në shumën 549.953 lekë, për t'i dhuruar shumën prej 200.000 lekësh, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

4.8 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij ka parashtuar se në analizimin e mundësisë financiare të familjes së tij, Komisioni duhej të përfshinte edhe kursimet e prindërve përpara vitit 2000, pasi jo të gjitha kursimet e tyre ishin shpenzuar për shtëpinë, e cila sikundër rezulton edhe nga deklaratimet e babait të tij në deklaratën *Vetting*, se kjo banesë ishte ndërtuar, ndër të tjera, edhe me kontribute në formë ndihme nga vëllai emigrant në Greqi dhe Kanada, si dhe nga shitja e apartamentit në Gramsh.

4.9 Trupi gjykues në analizë të fakteve dhe provave për këtë depozitë arsyeton:

4.9.1 “Credins Bank” ka konfirmuar faktin se në emër të subjektit të rivlerësimit është çelur llogari depozite pranë kësaj banke me gjendje në datë 29.1.2017, në vlerën 17.501,38 euro. Ky deklarim mbështetet edhe nga dokumenti i administruar, kontratë depozite pa afat nr. ***, për

¹⁵Deklaruar qëllimi i përdorimit të kredive në pyetjen e dërguar në datën 27.4.2020.

individë në “Credins Bank” në emrin e subjektit me datë çelje më 24.10.2016, me interes 0,05%, bazë vjetore.

4.9.2 Lidhur me balancën negative në shumën 549,953 lekë, të aftësive financiare të prindërve të subjektit për t’i dhuruar atij shumën prej 200.000 lekësh, trupi gjykues pas dërgimit të shpjegimeve të subjektit, konstaton se nuk ka depozituar ndonjë dokument që mbështet pretendimet e tij, apo të ketë paraqitur një analizë financiare të ndryshme nga ajo e Komisionit.

4.9.2.a Megjithatë, trupi gjykues, në këtë çështje pavarësisht sa më sipër arsyetuar, nën çmuarjen e rrethanave faktike se:

i) kjo balancë negative lidhet me një periudhë ku subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë; ii) proporcionalisht ka vend për të vlerësuar me objektivitet, për shkak se nuk mund të përjashtohet mundësia e krijimit të të ardhurave të tjera nga familjarët e tij, mbi ato të përdorura për ndërtimin e objektit/shtëpi banimi, çka lë të nënkuptohet se ata mund të dispononin një shumë të caktuar për t’ia dhuruar subjektit nën një kontekst të caktuar,

çmon se pamjaftueshmëria financiare e prindërve në shumën 549.953 lekë, vlerësohet e tillë që nuk mund të ngrihet në nivelin e ndonjë kualifikimi ligjor për penalizimin e subjektit.

4.10 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar me saktësi këtë likuiditet, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të krijoj gjendjen *cash*, për të hapur depozitën në shumën prej 17.500 euro, sipas pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2014.

5. Gjendje e kursimeve *cash*

5.1 Subjekti ka deklaruar se burim janë kursime nga pagat dhe shpërblimet, ndër vite, për periudhën 2007 dhe aktualisht, të deklaruara më parë në ILDKPKI dhe të mbetura si gjendje *cash* (750.000 lekë) pas çeljes së llogarisë së depozitës si më sipër (pika 4). Në këtë shumë përfshihen edhe 150.000 lekë kursime të vitit 2016. Vlera: 900.000 (nëntëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 100 %.

5.2 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur se: subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat, të cilat e justifikojnë gjendjen *cash*.

5.3 Trupi gjykues, këtë çështje e ka trajtuar/arsyetuar në pikën 4, për të cilën nuk i kanë rezultuar problematika në krijimin e gjendjes *cash*.

Deklarimi i detyrimeve

6. Në vijim, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar një kredi konsumatore nr. ***, datë 12.5.2014, lidhur mes nënës N. A. dhe “Credins Bank”, me vlerë 1.000.000 (një milion) lekë, me qëllim blerjen e automjetit nga vëllai B. A. . Afati i kredisë 36 muaj. Kësti mujor 34.614,40 lekë. Subjekti ka deklaruar se është dorëzanës (garantor) së bashku me disa persona të tjerë vetëm për efekt dokumentacioni. Norma e interesit 14.9 % me bazë vjetore dhe se nuk ka paguar asnjë këst të kësaj kredie. Detyrimi 134.903 lekë (njëqind e tridhjetë e katërmijë dhe nëntëqind e tre).

6.1 Kjo kredi konfirmohet me kontratën e kredisë¹⁶ nr***, datë 12.5.2014, ku kredidhënës është “Credins Bank”, kredimarrës N. A. dhe dorëzanës G. A., Kreshnik Ajazi dhe L. K. . Vlera: 1.000.000 lekë, me qëllim kredi konsumatore (blerje automjeti).

¹⁶Aneksi nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

6.2 Trupi gjykues, nisur nga fakti se: (i) “Credins Banka”¹⁷ ka informuar se kjo kredi është disbursuar në datën 12.5.2014 dhe po në këtë datë është tërhequr *cash* shuma 990.000 lekë; (ii) nga analizimi i dokumentacionit bankar¹⁸, provohet fakti se qëllimi i kësaj kredie ka qenë për blerje automjeti dhe detyrimi i mbetur i kësaj kredie është në shumën 134.903,88 lekë; (iii) nga korrespondenca e mbajtur mes Komisionit dhe DPSHTRr-së¹⁹, kjo e fundit ka depozituar kontratën e blerjes së automjetit që daton më 12.5.2014, konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi deklarimi përputhet me qëllimin e marrjes së kredisë dhe detyrimin e mbetur me dokumentacionin e administruar.

7. Hua e marrë nga “Credins Bank”, në formën e overdraftit në monedhën lekë

7.1 Marrëveshja e lidhur në datën 29.10.201 është ripërtërirë me kontratën nr. ***, datë 18.11.2014 dhe me kontratën nr. ***, datë 23.11.2015. Shuma e huas 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Afati 1-vjeçar dhe norma e interesit 16 % në vit. Kontrata lidhet me kartën e kreditit *visa elektron classic*. Kjo llogari është përdorur vetëm për blerje *online* dhe çdo shpenzim është mbuluar me urdhërxhirim të brendshëm me të ardhura nga paga. Subjekti ka bashkëlidhur kontratat e sipërcituara dhe nëntë fletë statement printuar nga sistemi bankar i “Credins Bank” në datën 24.1.2016 dhe dy fletë printuar nga aplikacioni i llogarisë. Gjendja e disponueshme 52.951,97 (pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë me tepriçë 2.951,97 (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

7.2 Nga korrespondenca e mbajtur mes Komisionit dhe “Credins Bank”, kjo e fundit me shkresën nr*** prot., datë 18.12.2019, informon se z. Kreshnik Ajazi ka produktin bankar *karta visaclassic* në lekë, pranë kësaj banke dhe gjendja e kësaj llogarie më 29.1.2017 është në vlerën 2.851,97 lekë.

7.3 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit provues sipas pikës 7.1, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “Credins Bank”, duke mos konstatuar ndonjë problematikë lidhur me këtë hua në formën e overdraftit.

Deklarim i vëllait të subjektit, z. B. A.

8. Automjet i markës “Mercedes Benz” me targa *, vit prodhimi 2000**

8.1 Automjeti është blerë sipas kontratës noteriale nr***, datë 12.5.2014, lidhur mes z. B. A. si blerës dhe shitësit M. B., shuma e blerjes (ku përfshihen edhe detyrimet e zhdoganimit të paguara nga shitësi) është 850.000 lekë. Burimi i të ardhurave për këtë blerje është një pjesë nga shuma e kredisë bankare konsumatore e marrë me kontratën e kredisë nr. ***, datë 12.5.2014, lidhur mes nënës N. A. dhe “Credins Bank”, me vlerë 1.000.000 (një milion) lekë, me qëllim blerjen e automjetit. Subjekti ka bashkëlidhur një kopje e kontratës së shitblerjes së sipërcituar të automjetit, një kopje të certifikatës së pronësisë së mjetit rrugor ***, datë 13.5.2014, një kopje të kartelës së mjetit, si dhe një kopje të deklaratës doganore të importit IM4. Vlera: 850.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

¹⁷Shkresë nr. ***prot., datë 18.12.2019.

¹⁸Kontrata e kredisë nr. ***, datë 12.5.2014.

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2019.

8.2 Nga dokumentacioni i administruar ky automjet konfirmohet me kontratë shitblerje²⁰ nr. ***, datë 12.5.2014, me palë shitëse shtetasin M. B. dhe palë blerëse shtetasin B. A. . Vlera e automjetit: 850.000 lekë.

8.3 DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2019, ka informuar se shtetasi B. G. A. ka pasur të regjistruar në pronësi të tij automjetin me targa *** dhe ka depozituar të gjithë dokumentacionin mbështetës, i cili është shitur më 28.2.2019.

8.4 “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2019, konfirmon marrjen e kredisë në vlerën 1.000.000 lekë, e cila është disbursuar më 12.5.2014 dhe, po në këtë datë, është tërhequr *cash* shuma prej 990.000 lekësh. Qëllimi i kësaj kredia ka qenë për blerje automjeti dhe nga dokumentacioni i administruar provohet ky fakt.

8.5 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit provues sipas (8.1-8.3), por trajtuar edhe në pikën 6 të këtij vendimi, konkludon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet për personin e lidhur me të, duke mos konstatuar ndonjë problematikë për këtë pasuri.

9. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në monedhën lekë

9.1 Subjekti ka bashkëlidhur statement të nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht, printuar nga sistemi i bankës, si dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 27.1.2017, të “Raiffeisen Bank”. Në këtë llogari është kredituar paga, si dhe overdrafti, në të cilin janë bërë tërheqje që mbulohen po nga të ardhurat e pagës. Gjendja aktuale është debi në shumën 269.442,42 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

9.2 Nga hetimi administrativ, rezultoi se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019, ka konfirmuar faktin se shtetasi B. A. ka llogari pranë kësaj banke dhe gjendja e llogarisë rrjedhëse/overdraft në të cilën kreditohet paga në datën 29.1.2017 (që është data e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti), është në vlerë negative në shumën 269.442,42 lekë. Në këto rrethana, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.

10. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, në monedhën lekë

10.1 Subjekti ka bashkëlidhur statementin e nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht, printuar nga sistemi i bankës. Gjendja aktuale është në shumën 72.55 lekë. Pjesa takuese: 100%.

10.2 Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2019, ka konfirmuar faktin se shtetasi B. A. ka llogari pranë kësaj banke dhe se gjendja e llogarisë rrjedhëse në datë 29.1.2017 është në vlerën 72.55 lekë. Në këto rrethana trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”.

11. Gjendje e kursimeve *cash*

11.1 Lidhur me gjendjen *cash* burim janë kursime nga pagat dhe shpërblimet nga punësimi, ndër vite, të deklaruara më parë në ILDKPKI. Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

11.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarime për familjarët në lidhje me të ardhurat dhe kursimet e tyre (*cash* apo në bankë).

11.3 Komisioni, analizën financiare të subjektit e ka kryer së bashku me familjarët, duke përfshirë sipas dokumentacioneve zyrtare të ardhurat dhe likuiditetet e tyre. Në lidhje me gjendjen *cash* të vëllait, shtetasit B. A., meqenëse nuk janë deklaruar kursimet, Komisioni nuk

²⁰Aneksi nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

mund të përcaktojë saktësisht kur janë krijuar këto kursime *cash*, sa janë shtuar apo pakësuar ato çdo vit, etj.

11.4 Trupi gjykues, duke konstatuar se në tërësi, gjendja financiare e familjes Ajazi, ka përfshihet subjekti dhe familjarët e tij, rezulton në balancë pozitive, por edhe për faktin që, nëse do të prezumonin se gjendja *cash* prej 5.000 euro të ishte krijuar në vitin 2016, sërish kjo analizë financiare rezulton në balancë pozitive dhe, në këto kushte, çmon se nuk konstatohet ndonjë problematikë për krijimin e gjendjes *cash*.

Deklarimi i detyrimeve financiare

12. Kredi konsumatore me nr. 272906, datë 13.4.2016, në “Raiffeisen Bank”, me vlerë 510.000 lekë (pesëqind e dhjetë mijë) lekë. Afati i kredisë 3 vjet, nga prill i vitit 2016 – 2019. Kësti mujor 15.000 lekë (principal dhe interesa). Aktualisht likuiduar 105.636,41 lekë, principal dhe 20.155,67 lekë interes. Këstet e kësaj kredie likuidohen nga paga. Kredia është disbursuar nga banka në llogarinë e subjektit në datën 13.4.2016. Subjekti ka bashkëlidhur vërtetimin nr. *** prot., datë 27.1.2017, të “Raiffeisen Bank”. Shuma e detyrimit është në vlerën 404.363,59 lekë.

12.1 Nga hetimi administrativ, rezultoi se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr.***prot., datë 21.10.2019, ka konfirmuar faktin se shtetasi B. A. ka nënshkruar kontratën e kredisë, datë 12.4.2016, për shumën 510.000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë ka qenë për përdorim *Pre-selected*. Detyrimi i mbetur i kësaj kredie është në vlerën 404.363,59 lekë.

12.2 Në këto rrethana, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.

Deklarimi i nënës së subjektit N.A.

13. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në monedhën lekë

13.1 Bashkëlidhur statement i nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht printuar nga sistemi i bankës. Në këtë llogari janë kryer vetëm veprime të kreditim/tërheqjes së rrogës dhe pagesa të kredisë. Veprimi i fundit në llogari është kryer në datën 30.3.2012. Gjendja aktuale është 30,96 lekë. Pjesa takuese: 100%.

13.2 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019, ka konfirmuar faktin se shtetasja N. A. ka llogari pranë kësaj banke dhe gjendja e llogarisë në datën 29.1.2017, është 0 (zero) lekë. Trupi gjykues, sipas dokumentacionit të administruar, vëren se deklarimi i subjektit i korrespondon datës 31.12.2016, konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.

14. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, në monedhën lekë

14.1 Bashkëlidhur statement i nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht printuar nga sistemi i bankës. Në këtë llogari janë kryer vetëm veprime të kreditim/tërheqjes së rrogës dhe pagesa të kredisë. Gjendja aktuale është 1.867,25 lekë, 100 %.

14.2 Nga hetimi administrativ, rezultoi se “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2019, ka konfirmuar faktin se znj. N. A. ka llogari pranë kësaj banke dhe gjendja e llogarisë në datën 29.1.2017 është në vlerën 567.25 lekë, ndërsa më 12.1.2017 është në vlerën 1.867,25 lekë. Trupi gjykues bazuar në dokumentacionin e administruar vëren se deklarimi i

korrespondon datës 12.1.2017. Në këto rrethana, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”.

15. Bashkëpronare në pjesë ideale, si një ndër trashëgimtarët e ish-pronarit F.M. gjyshi nga nëna) i pasurisë truall me sip. 3000 m², në fshatin K., Lushnjë dhe 15 hektarë tokë arë në K. dhe S., Lushnjë, sipas vendimeve nr. ***, datë 12.4.1995 dhe nr. ***, datë 26.5.1999, të ish-KKK Pronave Lushnjë, për të cilat ka vendosur kompensim me obligacione.

15.1 Këto pasuri nuk janë regjistruar në ZVRPP, pasi janë ndarë në bazë të ligjit nr. 7501/1991 dhe nuk është përfituar asnjëherë asnjë e ardhur nga kompensimi apo çdolloj veprimi me këto pasuri, të cilat aktualisht janë në fazë shqyrtimi për kompensim nga AKKKP-ja Tiranë. Pasuritë nuk janë vlerësuar me vlerën aktuale të tregut, pasi nuk ka vendimmarrje në favorin e tyre nga AKKKP-ja. Pra, këto pasuri deri aktualisht vetëm janë njohur por nuk është kryer asnjë veprim për regjistrim të tyre për shkak se janë zënë nga subjekte të tjera ose ndarë me ligjin nr. 7501/1991 dhe se subjekti së bashku me familjarët e tij nuk ka përfituar asnjë qindarkë nga fondi i kompensimit të ish-pronarëve në të holla dhe as kompensim në natyrë. Bashkëlidhur praktika e plotë, vendimet e ish-KKKP-së, vendim i AKKKP-së dhe vendim gjyqësor. Sipas vendimit të ish-KKKP-së, trualli ka vlerë 320 (treqind e njëzet) lekë/m² dhe ara ka vlerë në total 3.416.000 (tre milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë. Pjesa takuese: 12%.

15.2 Dokumentacioni i administruar²¹ si vijon:

i) procesverbal, datë 14.7.2009, për subjektin e shpronësuar F.M., lëshuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për kompensim në të holla;

ii) shkresë kthim përgjigjeje nr. ***, datë 15.6.2007, nga Arkivi Shtetëror Vendor Fier, mbi kërkimin për të dhëna në emër të shtetasit F. M.;

iii) faturë arkëtimi në emrin e znj. N. A., nr. ***, datë 14.7.2009, sipas të cilës identifikohet aplikimi prej saj për kompensim financiar;

iv) vendim nr. ***, datë 26.5.1999, lëshuar nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Lushnjë me nr. *** prot., datë 17.6.1999, sipas të cilit është vendosur njohja e pronësisë në emër të ish-pronarit F. M., si dhe mënyra e kthimit dhe kompensimit trashëgimtarëve të tij, të një sipërfaqe prej 15 hektarë;

v) vendim nr. ***, datë 12.4.1995, lëshuar nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Lushnjë me nr. *** prot., datë 12.6.1995, sipas të cilit është vendosur njohja e pronësisë për truall me sip. 3000 m² dhe për shkak se identifikohet e zënë është vendosur kompensimi i saj me obligacione;

vi) vendim nr. ***, akti ***, datë 25.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me gjyqtar B.M.;

vii) njoftim vendimi nr. ***, datë 26.11.2009, i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, së bashku me vendimin e dhënë nga ky institucion.

Trupi gjykues ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur.

15.2.a Përveç konkludimit të saktësisë së deklarimit, trupi gjykues, duke konstatuar se: (i) kjo pasuri identifikon nënën e subjektit si përfituese nga të drejtat e saj trashëgimore, nëpërmjet vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që në vitin 1999; (ii) nga hetimi nuk u identifikua ndonjë përfitim financiar prej saj/pasurisë, nën analizimin e të gjitha fakteve, provave dhe rrethanave konkrete, çmon se nuk konstatohet ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.

²¹Shihni Aneksin nr. 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së.

Detyrime financiare

16. Kredi konsumatore nr. *, datë 12.5.2014**

16.1 Kredi në “Credins Bank”, me vlerë 1.000.000 lekë (një milion) lekë dhe me qëllim blerjen e automjetit nga djali i subjektit B. A. . Afati i kredisë 36 muaj me këst mujor në shumën 34.616,40 lekë dhe me normë interesi 14,9% me bazë vjetore. Kredia është disbursuar nga banka në llogarinë e subjektit në datën 12.5.2014 dhe përfundon më 9.5.2017. Dorëzënës për efekt dokumentacioni është edhe djali i subjektit Kreshnik Ajazi. Bashkëlidhur 11 fletë kontrate kredie bankare të sipërcituar dhe vërtetimi i datës 23.1.2017, nga “Credins Bank”. Shuma e detyrimit 134.903 lekë.

16.2 Trupi gjykues e ka arsyetuar dhe ka konkluduar për këtë kredi nën titullin *deklarimi i detyrimeve* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

Deklarim i babait të subjektit G. A.

17. Automjet i markës “Daimler-Crysler”, me targa *, viti i prodhimit 2002**

17.1 Automjeti është blerë sipas kontratës noteriale nr***, datë 22.7.2014, lidhur mes blerësit dhe shitësit P.B., shuma e blerjes (ku përfshihet edhe detyrimet e zhdoganimit të paguara nga shitësi) është 3.000 euro. Burimi i të ardhurave për këtë blerje kanë qenë kursimet nga të ardhurat e të ligjshme, ndër vite, si dhe ka bashkëlidhur: kopje të kontratës shitblerjes së sipërcituar të automjetit; kopje të certifikatës së pronësisë së automjetit rrugor ***, datë 22.07.2014; kopje të kartelës së automjetit, si dhe kopje të deklaratës doganore të importit IM4. Vlera: 3.000 (tremijë) euro. Pjesa takuese: 100%.

17.2 Trupi gjykues, për këtë pasuri, konstatoi se ky automjet konfirmohet me kontratë shitblerje²² nr. ***, datë 22.7.2014, me palë shitëse shtetasin P. B. dhe palë blerëse shtetasin G.A. . Vlera: 3.000 euro.

17.3 Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor/DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2019, ka informuar Komisionin se shtetasi G. S. A. ka pasur të regjistruar në pronësi disa automjete, duke informuar për secilën targë, si dhe ka depozituar dokumentacionet përkatëse.

17.4 Nga aktet e administruara nga DPSHTRr-ja, konfirmohet fakti se automjeti i markës “Daimler-Crysler”, me targa ***, ka qenë në pronësi të shtetasit G. A. dhe është shitur në datën 9.11.2017.

17.5 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, konkludon se subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri dhe se personi i lidhur me të ka pasur mundësi të investojë në blerjen e saj, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera, sikurse pasqyrohet edhe në pikën 4.4 të këtij vendimi.

18. Llogari rrjedhëse në “ProCredit Bank” , në monedhën lekë

18.1 Bashkëlidhur statement i nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht, printuar nga sistemi i bankës. Gjendja aktuale është 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100 %.

²²Aneksi nr. 4/16 në dosjen e ILDKPKI-së.

18.2 Nga hetimi administrativ u vërejt se “ProCredit Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2019, ka konfirmuar faktin se shtetasi G. A. është klient i saj dhe se gjendja e llogarisë në datën 29.1.2017 është në vlerën 0 (zero) lekë. Në këto rrethana, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “ProCredit Bank”.

19. Llogari rrjedhëse në BKT, në monedhën lekë

19.1 Bashkëlidhur statement i nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht printuar nga sistemi i bankës dhe vërtetimi, nr. *** prot., datë 21.10.2015. Gjendja aktuale është 2.200 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

19.2 Nga hetimi administrativ, u vërejt se BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2019, ka konfirmuar faktin se shtetasi G. A. ka llogari pranë kësaj banke dhe se gjendja e llogarisë në datën 29.1.2017, është në vlerën 2.206,79 lekë. Në këto rrethana, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga Banka Kombëtare Tregtare.

20. Truall me sip. 293.5 m², ku 143.9 m² shtëpi banimi njëkatëshe

20.1 Kjo pasuri është me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë Njësia Bashkiake Nr. ***, rruga “****”, nd****, h. ***, Tiranë dhe është deklaruar te ALUIZNI për legalizim në datën 7.2.2005. Shtëpia ka filluar të ndërtohet në nëntor të vitit 1996 dhe është bërë pjesërisht funksionale në maj të vitit 1997 dhe ka marrë formën aktuale në nëntor të vitit 1999. Trualli dhe banesa aktualisht janë në proces legalizimi. Me VKM-në nr. 677, datë 18.6.2009, është miratuar kalimi në pronësi të parcelës ndërtimore në favor të poseduesve. Vlera e përafërt e blerjes së truallit dhe e ndërtimit të objektit, sipas çmimeve të kohës është rreth 3.000.000 (tre milionë) lekë. Burim kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit të fituar me privatizim në Gramsh (bashkëlidhur kontrata nr****, datë 7.1.1997), kursime familjare, ndër vite, si dhe kontribute në formë ndihme nga vëllai emigrant në Greqi dhe Kanada. Nuk është e regjistruar në ZVRPP dhe, për këtë arsye, nuk ka vlerësim aktual sipas rregullave, pasi është në proces legalizimi, bashkëlidhur praktika. Vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

20.2 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratat periodike prej fillimit të detyrës si adresë banimi.

20.3 Pasuria sipas deklaramit por edhe dokumentacionit të identifikuar dhe arsyetuar në vijim, rezulton se është krijuar përpara se subjekti të bëhej subjekt deklarues.

20.4 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale²³, fillimisht nuk konfirmoi praktikë legalizimi të administruar në emër të babait të subjektit, pasi praktika e përcjellë nga ASHK-ja pasqyrore të dhëna për legalizim në emër të shtetasit G. S. A. me datëlindje 10.3.1967, që nga verifikimi i kryer nuk rezultoi të ishte i njëjtë person me atë të babait të subjektit me datëlindje 7.2.1952.

20.5 UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2019, informon se shtetasi G. S. A. ka kontratën nr. ***, për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë, me status “aktiv”, në kategorinë e konsumatorëve familjar me detyrime të likuiduara deri në gusht të vitit 2019. Dokumentacioni i disponuar për kontratën nr. *** është regjistri i kontraktuesve i vitit 2002.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2019.

20.6 OSHEE-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2019, informon se me gjeneralitetet G. S. A., identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit me Nr. ***, në instancën e Tiranës (identifikohet në informacion se matësi është vendosur më 3.8.1999).

20.7 Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se vetëdeklarimi për legalizim daton më 7.2.2005, në emër të shtetasit G. S. A. për banesë + lokal, një kat me sip. trualli 299 m² dhe sip. ndërtimi 180 m². Në këtë formular saktësohet se objekti është ndërtuar në vitin 1997, me adresë: Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, pranë ***, Tiranë.

20.8 Po ashtu, sipas dokumentacionit të praktikës së vetëdeklarimit (dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI²⁴) konstatohen:

- i) mandatpagesat datë 26.12.2008 dhe 24.3.2005, të babait të subjektit me qëllim kryerjen e shërbimeve për legalizimin e objektit;
- ii) deklaratë personale datë 30.1.2009;
- iii) deklaratë për zbatimin e planit rregullues;
- iv) certifikatë fiskale familjare e Njesisë Bashkiake Nr. ***, për likuidimin e detyrimeve vendore;
- v) mandatpagesat e babait të subjektit, nr. ***, datë 8.9.2008, nr. ***, datë 8.9.2008 dhe nr. ***, datë 17.8.2007,
- vi) konfirmimi nr. ***, datë 5.10.2015, lëshuar nga Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, sipas të cilit babai i subjektit G. A. ka bërë vetëdeklarimin nr. *** prot., datë 7.2.2005, për një objekt me funksion banim me sip. 180 m² dhe numri i kateve 1 (një);
- vii) fletorja zyrtare nr. 99, datë 3.7.2009, ku pasqyrohet miratimi i kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore në favor të poseduesit të ndërtimit informal, të shtetasit G.A., identifikuar me nr. rendor ***;
- viii) kontratë shitje apartamenti nr. ***, datë 7.1.1997, me shitës G. A. dhe blerës S. D. me shumën 800.000 lekë, sipas të cilës pasqyrohet se shuma është likuiduar nga blerësi në dy këste.

20.9 Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me disa paqartësi mbi ndërtimin e objektit dhe, më konkretisht, është pyetur nëse përtej vitit 1999 janë kryer ndërtime të tjera, si p.sh., shtesa, nisur edhe nga fakti se në vetëdeklarimin e babait të subjektit cilësohet *ndërtim objekti plus lokal*. Po ashtu, subjektit i është kërkuar të saktësojë nëse është legalizuar ndërtimi informal dhe për këtë i është kërkuar edhe dokumentacioni provues si dhe foto të ndërtimit.

20.9.i Subjekti në shpjegimet²⁵ e dhëna ka qartësuar...*nga biseda e bërë me babanë sot për deklarimin e tij në vitin 2005 ai më sqaron se ka kryer vetëdeklarimi për shtëpinë duke shënuar sipërfaqen 180 m² pasi ka bërë matjen e sipërfaqes së shtëpisë nga tarraca, që i takon matjes së bashku me arkitrarët që janë zgjatime të kolonave në rrafshin horizontal të pjesës së sipërme të përparme të banesës. Ndërsa në fakt nga specialistët e ALUIZNI matja e sipërfaqes së banesës është bërë nga themelet. Për pjesën “banesë dhe lokal” babai më sqaron se në vitin 2005 të deklarimit ka kuptuar se sipas ligjit të legalizimit të kohës duke e deklaruar kështu do t'i jepej mundësia që në një moment të dytë një pjesë të shtëpisë ta kthente për minimarket ose aktivitet biznesi të vogël në lagje. Në fakt, asnjëherë dhe asnjë milimetër katror e shtëpisë nuk ka qenë dhe nuk është përdorur në funksione të ndryshme nga banimi... Për shkak të miturisë në kohën e ndërtimit të shtëpisë nuk kam dhënë asnjë kontribut financiar në ndërtimin e saj... nga viti 1999 nuk është bërë asnjë ndryshim në asnjë milimetër katror të shtëpisë, as në sipërfaqe, as në kompozim, as në numrin e kateve dhe as në zgjerim apo ngushtim të banesës ekzistuese. Ndërtesa aktuale është identike me ndërtesën e vitit 1999. Banesa është legalizuar sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 27.11.2020, të ALUIZNI-t në emër të G.A. . Objekt banimi*

²⁴Shihni Aneksin nr. 4/19 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵Përcjellë me e-mail datë 17.5.2021.

*një kat, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë, z. k. ***, nr. pasurie ***, me sip. parcelës ndërtimore 293.5 m² dhe sip. ndërtimi për banim 145.1 m², nr. kateve mbi tokë: një. Kjo leje legalizimi sipas ligjit ka kaluar më pas pranë ZVRPP Tiranë për regjistrim dhe nga ASHK Tiranë është regjistruar vetëm ndërtesa. Për këtë është lëshuar certifikata për vërtetimin e pronësisë sipas së cilës rezulton në emër të G. A.: pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji pasurisë ndërtesë, sip.145.1 m², me përshkrimin godinë banimi 1 kat. Sqarohet se në ZVRPP është regjistruar në emër të babait vetëm banesa dhe jo sipërfaqja e parcelës ndërtimore deri në daljen nga qeveria të VKM-së për shpronësimin (kompensimin financiar) e pronarit të sipërfaqes së truallit (shih kufizimin në kartelën e pasurisë). Subjekti gjithashtu ka deklaruar ... nga babai im G. S. A. nuk është lidhur asnjë kontratë dhe për rrjedhojë nuk është paguar asgjë për parcelën ndërtimore... Sikundër e kam sqaruar më sipër nga ASHK është proceduar me regjistrimin e vetëm banesës dhe jo të parcelës. Bazuar në ligjin nr.9482/2006 (i ndryshuar), VKM nr.465/2016 dhe ligjin nr.20/2020, në terma të përmbledhura sqarohet se kontrata për kalimin e pronësisë mbi sipërfaqen ndërtimore për poseduesit e objekteve që i nënshtrohen legalizimit lidhet pas miratimit me VKM të kompensimit financiar të pronarit të parcelës ndërtimore. Pra në mënyrë që parcela të kalojë në pronësi të poseduesit të objektit të legalizimit është e nevojshme që më përpara të miratohet kompensimi financiar i pronarit të parcelës... Nga babai im G. S. A. janë paguar për legalizimin dhe regjistrimin e banesës: (1) 23.299 lekë taksë për ndikimin në infrastrukturë për ndërtimet e reja; (2) 300 lekë komision bankar; (3) 8.500 lekë regjistrim pasurie, lëshim certifikate, karteles pasurie dhe HTR; (4) 100 lekë komision ZVRPP, pra, në total janë paguar 32.199 (tridhjetë e dy mijë dhe njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë. Sipas aktit njoftim detyrimi të Bashkisë Tiranë (DPTTV) rezulton se vlera e detyrimit mbi G. A. për taksën për ndikimin në infrastrukturë për ndërtimet e reja është 23,298.7 lekë (paguar nga babai 23.299 lekë)”.*

20.9 ii Subjekti ka depozituar: (i) kopje të librezës së pagesës së ujit për kontratën e furnizimit me ujë të pijshëm të vitit 1998 për të njëjtën banesë; (ii) lejelegalizimi nr. ***, datë 27.11.2020, nga ALUIZNI; (iii) planimetri nga ASHK-ja; (iv) genplan nga ASHK-ja; (v) certifikatë për vërtetim pronësie datë 10.12.2020; (vi) kartelën e pasurisë së paluajtshme, HTR e pasurisë; (vii) foto të gjendjes aktuale të ndërtesës; (viii) aktin e njoftimit/ detyrimi Bashkia Tiranë (DPTTV), datë 27.11.2020; (ix) mandatpagesë, datë 28.11.2020, nga “Credins Bank”; (x) formular aplikimi në *e-albania*, datë 1.12.2020, nga shtetasi G. A.; si dhe (xi) mandatarkëtimi në postë i datës 1.12.2020.

20.10 Më tej, edhe Drejtoria Vendore ASHK Tiranë Veri²⁶, ka dërguar praktikën e plotë të legalizimit të kësaj pasurie në emër të babait të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i praktikës dhe, më konkretisht, nga verifikimi i vetëdeklarimit të plotësuar nga babai i subjektit në datën 7.2.2005, rezulton se objekti është ndërtuar në vitin 1997. Leja e legalizimit për ndërtimin informal nr. *** është dhënë në datën 27.11.2020, për një objekt të ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe ndërtimi 145,1 m² dhe me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 293.5 m².

20.11 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, vërejtë se subjekti ka shpjeguar bindshëm ekzistencën e kësaj pasurie (llojin dhe sipërfaqen e saj), kohën e ndërtimit, ndërmarrjen e veprimeve nga babai i tij për legalizimin e objektit dhe se përputhet deklarimi i tij në deklaratën *Vetting* me deklaratimet përgjatë hetimit administrativ.

20.12 Trupi gjykues, nën çmuarjen e rrethanave të sipërcituara, por edhe të fakteve se: (i) kjo pasuri është krijuar/ndërtuar në vitet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë vetëm 16 vjeç, pra, minore; (ii) nga hetimi administrativ nuk u konstatua ndonjë kontribut apo investim i subjektit të rivlerësimit apo familjes së tij; (iii) subjekti ka paraqitur shpjegime dhe dokumentacion që

²⁶Me shkresën nr. ***prot., datë 27.5.2021.

konfirmon plotësisht deklaratimet e tij, konkludon se nuk konstatohen problematika për këtë pasuri.

21. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në monedhën lekë

21.1 Bashkëlidhur statement i nxjerrjes së llogarisë që nga çelja e saj dhe deri aktualisht printuar nga sistemi i bankës. Gjendja aktuale është 943.52 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

21.2 Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 21.10.2019, ka informuar se shtetasi G. A. ka llogari pranë kësaj banke dhe se gjendja e llogarisë në datën 29.1.2017, është në vlerën 943.52 lekë. Në këto rrethana, trupi gjykues konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.

22. Trupit gjykues, lidhur me kriterin e pasurisë, nga hetimi administrativ i kryer përmes korrespondencave të mbajtura me institucionet publike, konkretisht: ASHK-së, AMF-së, RNSH-së dhe sistemit *TIMS*, nuk i rezultoi (i) ekzistenca e ndonjë pasurie të luajtshme apo të paluajtshme në emër të subjektit të rivlerësimit; si dhe (ii) ndonjë problematikë apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje të regjistruara në sistemin *TIMS* me automjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga/dhe në adresë të subjektit.

23. Në konkluzion për rivlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

a. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin “DH” të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar Raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku në përputhje me pikën 2 të po këtij neni, ka konstatuar: *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Kreshnik Ajazi.*

b. Më tej, Komisioni kërkoi²⁷ përditësimin e raportit.

c. DSIK-ja ka dërguar raportin e përditësuar nr. *** prot, datë 20.4.2021, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 27.4.2021, të KDZH-së. Trupi gjykues edhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar lexoi të dhënat e informuara për subjektin e rivlerësimit.

i) Në raportin e përditësuar, ndër të tjera, citohet se në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, rezulton se: *“Informacionet e ardhura nga ana e autoriteteve verifikuese për subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi nuk ka tregues apo të dhëna që të evidentojnë implikimin e subjektit në më shumë se një rast”.*

ii) Në përfundim raporti citon se: *“Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi, gjykojnë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund*

²⁷Me shkresat nr. *** prot., datë 19.4.2021 dhe nr. *** prot., datë 23.4.2021.

të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj këtij subjekti”.

ç. Mbi *indiciet* e marra, Komisioni kërkoi²⁸ në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, depozitimin e fashikullit/jve penal në ngarkim të shtetasve S. M. dhe A. M. .

d. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan²⁹ ka përcjellë informacionin e nivelit “sekret”, si dhe dokumentacionin shoqërues.

dh. Nga verifikimi i të dy vendimeve penale të depozituara rezultoi si vijon:

i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr***, datë 30.7.2020, për çështjen me kërkues: Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, kundër: personave nën hetim, S. dhe A. M., të akuzuar se kanë kryer veprat penale “vrasje me paramendim kryer në bashkëpunim” dhe “mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 78 e 25 e 278/1 të Kodit Penal, me objekt “vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, në bazë të neneve 259 e 244 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur “pranimin e kërkesës, vleftësimin e ligjshëm të arrestimit, si dhe caktimin e masës së sigurimit personal ‘arrest me burg’ për secilin person nën hetim”.

ii) Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 22.12.2019, për të njëjtën çështje, por me objekt “zëvendësimin e masës së sigurimit të vendosur me vendimin e lartpërmendur”, ka vendosur “pranimin e kërkesës, zëvendësimin e masës së sigurimit me detyrim paraqitje pranë Oficerit të Policisë Gjyqësore, si dhe ndalimin e këtyre shtetasve për të dalë jashtë shtetit”.

iii) Nga verifikimi i të dy vendimeve rezulton se organi i akuzës nuk është përfaqësuar në gjykim nga subjekti i rivlerësimit.

e. Komisioni kërkoi³⁰ edhe dosjen/t gjyqësore që i përkasin vendimeve gjyqësore të cituara më sipër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan³¹ ka përcjellë dosjet gjyqësore. Nga aktet e administruara konstatohen disa veprime hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit.

i) Paraprakisht konstatohet se vepra penale është referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan³² në datën 21.7.2020.

ii) Në datën 21.7.2020, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar³³ ngritjen e grupit hetimor për hetimin e procedimit penal nr. ***. Në përbërje të këtij grupi ka urdhëruar prezencën e tij dhe të dy prokurorëve të tjerë.

iii) Në datën 29.7.2020, të tri prokurorët kanë vendosur³⁴ vleftësimin e ligjshëm të kontrollit të ambienteve të biznesit, varreza e makinave në pronësi dhe administrim të shtetasve A. dhe S. M. .

iv) Në datën 29.7.2020, subjekti i rivlerësimit dhe dy prokurorë të tjerë kanë kërkuar³⁵ vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të dy shtetasve të lartpërmendur për veprën penale “mbajtje pa leje e prodhimi i armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, si dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” për secilin prej tyre,

²⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2021.

²⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2021 e nivelit “sekret”.

³⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2021.

³¹Me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2021.

³²Nga OPGJ K. G. . Shihni f. 7 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 30.7.2020.

³³Shihni f. nr.7 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 30.7.2020.

³⁴Shihni f. 56 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 30.7.2020.

³⁵Shihni f. nr. 2 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 30.7.2020.

parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurave Penale, si autorë të dyshuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 78-25 dhe 278/1 të Kodit Penal. Në kërkimin e masës së sigurimit, ndër, të tjera është pasqyruar edhe përmbushja e nenit 229/2 të Kodit të Procedurave Penale, duke u argumentuar se në këtë rast rrezikshmëria shoqërore për veprën për të cilën dyshohen dy të arrestuarit është e madhe, si dhe sanksioni që parashikohet për këtë vepër është minimumi pesëmbëdhjetë vjet burgim. Po ashtu, në këtë kërkim është pasqyruar edhe fakti se shtetasi S. M. rezulton me gjendje gjyqësore i dënuar³⁶.

v) Pas dhënies së masës së sigurimit “arrest në burg” janë kryer disa veprime hetimore, kryesisht janë bërë akte ekspertimi, kimik, balistik, biologjik, etj.

vi) Në datën 17.12.2020, subjekti i rivlerësimit së bashku me një tjetër prokuror kanë kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal³⁷ me karakter shtrëngues në “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”³⁸ dhe “ndalimin për të dalë jashtë shtetit”, parashikuar nga nenet 233 dhe 234 të Kodit të Procedurave Penale.

vii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 22.12.2019, ka pranuar dhe vendosur sipas kërkesës së organit të akuzës.

ë. Komisioni, për sa është cituar më sipër, nisur nga rrezikshmëria shoqërore për veprën penale të dyshuar (e cituar në kërkimin e vleftësimit të arrestit), nga fakti që njëri prej të dyshuarve ka rezultuar me gjendje gjyqësore i dënuar (për të cilën në vërtetimin e gjendjes gjyqësore nuk pasqyrohet vepra penale e kryer dhe as dënimi i dhënë), i ka kërkuar subjektit: (i) të japë shpjegime lidhur me kërkimin e bërë prej tij, për zëvendësimin e masës së sigurimit me karakter shtrëngues “arrest me burg”; (ii) të qartësojë nëse është ushtruar ankim mbi vendimmarrjen e zëvendësimit të masës së sigurimit dhe, nëse po, cili është statusi aktual i gjykimit; (iii) të depozitojë dokumentacionin mbështetës; si dhe (iv) të shpjegojë për sa ka rezultuar në tërësi në raportin e përditësuar të DSIK-së, ndërthurur edhe me të dhënat e dosjeve penale.

Subjekti në shpjegimet³⁹ e tij ka cituar ekzaktësisht: *“Çështja penale ndaj personave nën hetim S. dhe A. M. është në fazë hetimi paraprak. Për shkak të kompleksitetit dhe zhvillimeve të fundit hetimore do të kërkoja mirëkuptimin tuaj sepse me duhet të jem shumë i kujdesshëm në ato çfarë parashitroj. Shtetasi A. dhe S.M. janë aktualisht persona nën hetim në kuadër të procedimit penal nr. ***, bashkuar me procedimin penal nr***, regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/2-25, 278, 279 të Kodit Penal. Këto procedime penale i përkasin ngjarjeve kriminale të vrasjes së viktimave E. R. dhe R. R., të ndodhura në Elbasan në korrik të vitit 2020. Në kuadër të këtyre procedimeve penale janë persona nën hetim edhe disa shtetas të tjerë dhe konkretisht të arrestuarit E .A., Xh. H. dhe E. H., të dyshuar si porositës, organizator dhe ekzekutorë në ngjarje. Rezulton se të hetuarit A. dhe S. M. janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore dhe me vendimin nr***, datë 30.7.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të këtyre shtetasve dhe të caktojë ndaj tyre masën e sigurimit personal “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurave Penale.*

*Me vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur të zëvendësojë masën e sigurimit për shtetasit A. M. dhe S. M. nga “arrest në burg” në “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “ndalim për të dalë jashtë shtetit” sipas neneve 233 dhe 234 të Kodit të Procedurave Penale për të dy këta shtetas.*

³⁶Shihni f. nr. ***, në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 30.7.2020.

³⁷Arrest me burg, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

³⁸Edhe të dyshuarit kanë bërë kërkesë për zëvendësim të masës së sigurimit në shtator të vitit 2020.

³⁹Për më tepër referojuni shpjegimeve të detajuara të subjektit të rivlerësimit, pasi Komisioni mban në konsideratë sensitivitetin e kësaj çështjeje.

Zëvendësimi i masës së sigurimit është vlerësuar pas një analizë mes grupit hetimor të prokurorisë dhe strukturave hetimore të policisë së shtetit dhe ka qenë rrjedhojë e veprimeve hetimore konkrete të kryera, të tilla si mjete për kërkimin e provës, metoda speciale hetimi, ekspertime daktiloskopike, të dhëna dhe analiza të tabulateve telefonike, këqyrje të pamjeve filmike, deklarimeve etj. Sipas konkluzionit të policisë së shtetit (ndodhur në dosjen hetimore) rezultojnë (citoj): ‘Nga tërësia e veprimeve hetimore, indicieve dhe provave të grumbulluara të paraqitura më sipër për dy shtetasit e arrestuar A.M. dhe S.M. të cilëve në oborrin e servisit të makinave u është gjetur e fshehur në tokë e mbuluar me një serbator makine të çmontuar, arma e zjarrit pistoletë ngjyrë e zezë, (Armë objekt ekspertimi me numër të stampuar në tytë ..., kalibër 7.62 mm (7.62x25), armë e shkurtër zjarri pistoletë e modelit 57 kalibrit 7.62 x 25 mm gjysmëautomatike) e cila ka shërbyer për ekzekutimin e shtetasit E.R., (argumentuar edhe më sipër) nga ana jone lindë dyshimi i arsyeshëm që kjo armë mund të jetë vendosur nga autori/ët apo ndihmësit (të pidentifikuar akoma nga ana jonë) e tyre qëllimisht për të devijuar hetimin si dhe për t’ju shmangur përgjegjësisë ligjore’.

Subjekti në vijim ka deklaruar: “Ky procedim penal kryesisht është i nivelit sekret ...sikurse nga prokurori i çështjes është nxjerrë urdhri, datë 7.8.2020, për ruajtjen e sekretit sipas nenit 279 të Kodit të Procedurave Penale, në të cilin është urdhëruar: ‘ruajtja e sekretit të aktit datë 7.8.2020 dhe të akteve që janë prodhuar si pasojë e kësaj deri në përfundim të hetimit paraprak’...”.

*Mbi vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk është ushtruar ankim dhe ka marrë formë të prerë në datën 28.12.2020 (Subjekti ka depozituar vendimin e lartpërmendur)”.*

Më tej, subjekti ka sqaruar se: “Në lidhje me informacionet e dërguara nga DSJK-ja parashitroj se jam dakord me përshtatshmërinë me detyrën e konkluduar për mua nga ky institucion në raportin e parë dhe të konfirmuar në raportin e dytë. Qëndrimi i grupit hetimor për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj shtetasve M. ka qenë thelbësishëm i bazuar në provat e administruara nga hetimet dhe dinamika e akteve të administruara, nga verifikimet e thelluara që i përkasin kësaj pjesë të hetimit, në përputhshmëri të plotë dhe në rakordim me strukturat hetimore të policisë së shtetit të cilët kanë raportuar me shkrim mendimin e tyre mbi rezultatet e hetimeve për këtë pjesë dhe ka gjetur mbështetje në gjykatë pasi i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor”.

Trupi gjykues, në analizë të fakteve të konstatuara, shpjegimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të administruar, arsyeton si vijon:

i. Vlerësuar në aspektin procedural të aplikimit të dispozitave ligjore të kërkimit të masës së sigurimit, si dhe zëvendësimit të saj, nga organi i akuzës, vërehet se ky kërkim gjendet i bazuar në nenin 244 ku shprehimisht thuhet: “Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa” dhe në nenin 260/4 të Kodit të Procedurave Penale, ku parashikohet se: “Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet”. Pra, në këtë analizë roli dhe pozita e subjektit të rivlerësimit ka qenë në përputhje me parashikimet ligjore.

Më tej, në mënyrë kronologjike dhe ligjore kërkesa e zëvendësimit të masës së sigurimit adresohet si rezultat i krijimit të kushteve dhe rrethanave të reja nga vleftësimi i parë, të cilat çmohen dhe ligjërohen nga gjykata. Edhe në këtë drejtim duket se kërkimi i drejtë dhe në përputhje me ligjin merr një vlerë të caktuar në këtë gjykim.

ii. Parë në kontekstin se gjendemi përpara zëvendësimit të masës së sigurimit personal nga ajo më e rëndë në një më të lehtë, për dy persona të dyshuar për kryerje të një veprë penale, ajo që

kërkon pikë së pari provueshmëri është situata në të cilën u vendos njëra masë dhe rrethanat që diktuan zëvendësimin e saj. Në këtë këndvështrim nga aktet e administruara dhe shpjegimet e subjektit identifikohen veprime hetimore të kryera pas dhënies së masës së sigurimit personal “arrest me burg”. Ndër to, janë evidentuar kryesisht kryerja e *ekspertimeve daktiloskopike, të dhëna dhe analiza të tabulateve telefonike, këqyrje të pamjeve filmike, etj.* Nga ana tjetër subjekti ka qartësuar edhe mbi veprime të tjera hetimore të kryera në bashkëpunim me strukturat hetimore të policisë, sikurse i ricitoi edhe në seancë dëgjimore, përfshirë këtu edhe metodat speciale të hetimit, për të konkluduar në vlerësimin e ndryshimit të masës së sigurimit personal. Duket se veprimet dhe arsyetimi i bërë në gjykatë, kanë ndikuar në vlerësimin e rrethanave dhe fakteve të reja që kane dalë nga ky hetim, të cilat ashtu sikurse parashikohet në pikën 1 të nenit 228, janë të lidhura me dyshimet e arsyeshme të kryerjes së një vepre penale të cilat vlerësohen në raport me aplikimin e nenit 228 të Kodit të Procedurave Penale, ku sanksionohen kushtet e përgjithshme në caktimin e masës së sigurimit.

iii. Trupi gjykues çmon se dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova ose elementi provues (*fumus commisi delicti*), është kushti më i rëndësishëm dhe thelbësor që vlerësohet, pasi askush nuk mund t’i nënshtrohet masave të sigurimit personal nëqoftëse, në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova.

iv. Trupi gjykues çmon se ky dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova sipas pikës 1, të nenit 228, të Kodit të Procedurës Penale, ka të bëjë me ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe rrethanave të faktit, që për identifikimin e mundësive që provojnë fakte që jo vetëm se vepra penale është kryer, por dhe në drejtim të mundësisë se kjo vepër penale është kryer nga personi ndaj të cilit do të vendoset masa e sigurimit, do të thotë se, kërkohet detyrimisht përgjegjësia e personit që akuzohet.

v. Në këtë këndvështrim, lidhur me kërkesën e subjektit për ndryshimin e masës, trupi gjykues çmon se çdo rrethanë dhe prova të reja të parashtruara nga organi i akuzës, janë atribut vlerësimi i gjykatës, pra, lidhen me themelin e çështjes për të cilën Komisioni nuk ka kompetencë të shprehet.

vi. Përveç sa më sipër, trupi gjykues në këtë arsyetim, për të pasqyruar pozitën e subjektit në këtë çështje, në koherencë me parashikimet ligjore, mban në konsideratë edhe prezantimin e situatës sensitive që e karakterizon këtë çështje, sikurse ka shpjeguar edhe vetë subjekti dhe, për këtë shkak, trajtimi i saj me objektivitet bazohet edhe mbi disa argumente të renditur në vijim:

- nga aktet e dosjes rezultoi se çështja është komplekse dhe kryesisht e nivelit sekret;
- vetë subjekti ka qenë i rezervuar në dhënien e shpjegimeve me qëllim ruajtjen e procesit hetimor si një çështje në hetim e sipër;
- në rastin objekt hetimi përveç zëvendësimit të masës së sigurimit, është kërkuar edhe ndalimi i të akuzuarve/personave nën hetim, për të mos lejuar ikjen e tyre;
- gjithashtu, gjykata ka mbajtur të njëjtën linjë në zëvendësimin e masës së sigurimit të kërkuar nga organi i akuzës dhe për post kësaj rezultoi që ndaj vendimit të mos jetë ushtruar ankim.

vii. Në vijim, trupi gjykues vlerësoi të analizojë edhe mbi dy momentet e përshkruara në konstatimet fillestare të hetimit, konkretisht mbi ndikimin që mund të ketë gjendja gjyqësore e njërit prej të dyshuarve si dhe mbi rrezikshmërinë shoqërore për veprën penale të dyshuar. Në këtë drejtim, çmohet se, fakti që njëri prej të akuzuarve kishte qenë me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, sigurisht duket të jetë një rrethanë rënduese për të, por kjo rrethanë merr rëndësi në gjykimin e themelit të çështjes dhe në dënueshmërinë e individit kompetenca këto të gjykatës.

viii. Po ashtu, edhe në vlerësimin e çështjes së rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale të dyshuar, në tërësi çmohet se është vlerësim i gjykatës nëse procesi i vlerësimit dhe gjykimit për vendosjen/zëvendësimin ose jo të masës së sigurimit, është në përmbushje të kushteve dhe kritereve të parashikuara nga ligji. Më konkretisht, veç kushteve të përgjithshme, mbetet të verifikohet nëse, ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë: ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; largimi i të pandehurit ose rreziku që të largohet; rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet, pasi për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jokumulative. Në këtë këndvështrim, vlerësohet se çështja e rrezikshmërisë është një faktor që gjykata e mban parasysh në gjykimin e çështjes në tërësi dhe thelbësisht në vlerësimin e provave për kryerjen e një vepre penale dhe atribuimin e përgjegjësisë penale të personit të akuzuar.

ix. Së fundi, dinamikën e kësaj çështjeje, kompleksitetin dhe sensitivitetin e saj, veprimet e tjera hetimore, si dhe faktin e saj ende në proces, trupi gjykues i vlerëson si faktorë të cilët janë tërësisht të lidhur me themelin e çështjes dhe që mbeten në vlerësim të gjykatave sikurse e parashikojnë edhe dispozitat ligjore dhe konkretisht neni 229 e vijues i Kodit të Procedurave Penale.

x. Për sa më sipër, trupi gjykues, në konkluzion të kësaj çështjeje mbi dyshimet e ngritura, për sa kohë nuk konstaton shkelje procedurale dhe hetimet e tjera apo kërkesat e prokurorit janë të lidhura edhe me themelin e saj dhe janë vlerësim i gjykatës, nuk evidentoi rrethana për t'i ngarkuar përgjegjësi subjektit të rivlerësimit.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti⁴⁰ për këtë vlerësim është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë raport analizohen të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, i cili paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (ii) pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor për të cilat analizohet në vijim; (iii) të dhënave nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë; (iv) si dhe të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtorisë

⁴⁰Raporti nr. ***prot., datë 30.7.2020.

së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyrës së Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Analiza e gjetjeve⁴¹

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura me short; si dhe (iii) burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara rezulton se prokurori Kreshnik Ajazi, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

b) Arsytimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Kreshnik Ajazi shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Arsyetimin ligjor e mbështet jo vetëm në normat penale, por edhe në normat sipas specifikave të hetimeve që ka kryer, në doktrinë, konventa ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, si edhe në ligje specifike.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në formularin e vetëdeklarimit rezulton se për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 81 çështje.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 24.6.2020 në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se nga prokurori Kreshnik Ajazi tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë⁴² çështjeve të trajtuara.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

⁴¹Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

⁴²Konkretisht, kohëzgjatja e trajtimit të çështjeve që lidhen me dosjet 1, 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë respektivisht: dosja nr. 1 – materiali kallëzues nr. ***regjistruar më 21.8.2015 dhe mosfilluar më 25.8.2015 kohëzgjatja 4 ditë; dosja nr. 2 – procedimi penal nr. ***, regjistruar më 2.10.2015, pushuar më 11.3.2016, kohëzgjatja 5 muaj dhe 9 ditë; dosja nr. 3 – procedimi penal nr. ***, regjistruar më 8.9.2014, pushuar më 31.12.2015, kohëzgjatja 1 vit 3 muaj dhe 23 ditë; dosja nr. 4 – procedimi penal nr. ***, regjistruar më 2.12.2013, dërguar për gjykim më 23.12.2013, kohëzgjatja 21 ditë; dosja nr. 5 – procedimi penal nr. ***, regjistruar më 15.1.2014, dërguar për gjykim më 9.4.2014, kohëzgjatja 2 muaj e 26 ditë. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Kreshnik Ajazi ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuar dhe numrit total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga subjekti i rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për t'u kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimin. Aktet janë ndarë me paragrafe të numërtuara sipas specifikës së përmbajtjes së trajtuar për çdo paragraf.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Kreshnik Ajazi. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Kreshnik Ajazi për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”.

C/1 RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar përfshirë këtu tri⁴³ dokumentet ligjore të përzgjedhur nga subjekti, si dhe pesë⁴⁴ dosjet e përzgjedhura me short dhe çdo të dhënë tjetër shoqëruar raportit të rivlerësimit profesional, sikurse ka konkluduar edhe KLP-ja në raportin e saj, në tërësi nuk vërejtë problematika në lidhje me vlerësimin e këtij kriteri.

Në lidhje me denoncimet e depozituara në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016

Në adresë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë depozituar 12 denoncime, prej të cilëve tri denoncime që identifikojnë të njëjtin objekt ankimi janë depozituar të përsëritura nga të njëjtët denoncues.

1) Denoncimi⁴⁵ i shtetasit B. N.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, për veprën penale të kallëzuar prej tij për vetëgjyqësi, përfunduar me *mosfillim të procedimit penal*.

Të dhënat për këtë denoncim (sipas ankuesit) qartësojnë se çështja është vënë në lëvizje mbi referimin e policisë për shtetasen V. H., për shkak të disa veprimeve të kundërligjshme të kryera prej saj në dëm të pronës së blerë nga kallëzuesi.

Denoncuesi ka depozituar shkresën përcjellëse të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të njoftimit të vendimit në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2018, në adresë të tij. Denoncuesi nuk qartëson nëse e ka kundërshtuar këtë vendimmarrje. Pasi u kërku⁴⁶ fashikulli penal që i përket këtij kallëzimi penal, Prokuroria⁴⁷ ka informuar se *kallëzimi nr. *** është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** Akti, datë 7.3.2019. Në datën 26.7.2019, pas shfuqizimit të mosfillimit është regjistruar procedimi penal nr***. Ky procedim është në hetim.*

⁴³“Diskutim përfundimtar datë 8.10.2014”. Çështja penale nr. ***, viti 2013. I pandehur E. Sh. E. (a. Xh. E. ose E.) akuzuar për kryerjen e veprës penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” e parashikuar nga neni 100, paragrafi i II-të i Kodit Penal; “Diskutim përfundimtar datë 30.5.2014”. Shqyrtimi gjyqësor i çështjes me objekt “Njohjen e vendimit penal të huaj me qëllim transferimin dhe vazhdimin e ekzekutimit të dënimit në Republikën e Shqipërisë të të dënuarit I.B. (alias I. K.) sipas kërkesës së autoriteteve të drejtësisë së Britanisë së Madhe; “Diskutim përfundimtar, datë 02.06.2016”. Çështja penale nr. ***, viti 2015. E pandehur A. S. akuzuar për kryerjen e veprave penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, 8 herë, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, “vjedhje e bankave ose arkave të kursimit” më shumë se 1 herë dhe me pasoja të rënda parashikuar nga neni 136/II i Kodit Penal dhe “falsifikim të dokumenteve” më shumë se 1 herë dhe nga personi që ka për detyrë lëshimin e dokumentit parashikuar nga neni 186/II/III i Kodit Penal.

⁴⁴Dokumenti ligjor “vendim për mosfillimin e procedimit penal”, akt i datës 25.8.2015, si dhe aktet e materialit kallëzues nr. ***, viti 2015, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; dokumenti ligjor “Vendim për pushimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2015”, akt i datës 11.03.2016, si edhe aktet e procedimit penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; dokumenti ligjor “vendim për pushimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2014”, akt i datës 31.12.2015, si edhe aktet e procedimit penal nr. ***, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2013”, akt i datës 23.12.2013, si edhe aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2013, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2015”, akt i datës 9.4.2014, si edhe aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2014, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁴⁵Denoncimi nr. ***, datë 27.12.2018 dhe me e-mail datë 12.12.2018.

⁴⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2020.

⁴⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2020.

2) Denoncim⁴⁸ i shtetasit Gj.Gj.

Denoncuesi ankohet për disa subjekte rivlerësimi në pozicionin e gjyqtarit dhe prokurorit, ku ndër të tjerë, në parashtrimet e tij përmend edhe subjektin e rivlerësimit, objekt i këtij hetimi administrativ, por nuk paraqet rrethanë apo fakt konkret se për çfarë e denoncon subjektin. Ky shtetas sqaron mbi vendimmarrje të padrejta të organit të prokurorisë dhe atij gjyqësor lidhur me çështje pronësore.

Denoncuesi ka depozituar disa vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të Gjykatës së Apelit Durrës, akte të ndryshme pronësore, certifikata e skica planimetrike, ankesa dhe kthim përgjigje nga institucione të ndryshme, si edhe nga KLD-ja, por në asnjë prej dokumenteve nuk evidentohet ndonjë akt i ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, për të hetuar lidhur me këtë denoncim, i kërkoi⁴⁹ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan fashikullin që i përket këtij kallëzimi.

Nga verifikimi i akteve të administruara në fashikull⁵⁰ rezultoi se çështja penale që i përket procedimit nr. *** (i cili ka trajtuar kryesisht një kallëzim penal për çështje pronësore) është hetuar dhe përfunduar me vendimin e pushimit të saj datë 30.12.2014, nga një tjetër subjekt rivlerësimi.

✓ Në kushte të tilla konkludohet se pretendimet e denoncuesit ndaj subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë.

3) Denoncim⁵¹ i shtetasit K. Z., A. K.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. ***, regjistruar në emrin e tij, dyshuar për veprat penale që i përkasin neneve 186/a dhe 121/a të Kodit Penal. Denoncuesi pretendon se subjekti ka shpërdoruar detyrën duke vendosur deklarin e moskompetencës dhe duke ia kaluar çështjen për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke qenë se kallëzuesja dhe denoncuesi janë banorë të qytetit të Elbasanit. Denoncuesi sqaron se kallëzuesja e ka kallëzuar për përndjekje dhe për hapje të profileve të rreme, ndërsa ai pretendon se një fakt i tillë është i pavërtetë, duke sqaruar se ajo ka hapur një të tillë me qëllim marrjen e azilit politik në shtetin italian. Nga verifikimi i akteve të depozituara rezulton se nga oficeri i policisë gjyqësore i caktuar për hetimin e çështjes penale që i përket procedimit nr. ***, në relacionin e tij, pasi është shtjelluar kronologjia e veprimeve hetimore të kryera, ku ndër të tjera, citohet se: (i) është marrë në pyetje kallëzuesja F. N.; (ii) është ushtruar kontroll në banesën e denoncuesit; (iii) është administruar dhe verifikuar gjendja civile, më konkretisht, adresa e banimit përkatësisht e denoncuesit dhe kallëzueses, si dhe për faktin se iv) korrespondenca (dërgesa postare) ka rezultuar e dërguar në mënyrë të vazhdueshme nga Tirana në adresë të kallëzueses, i është sugjeruar subjektit të rivlerësimit dërgimi i çështjes për hetime të mëtejshme në Tiranë, pasi ka rezultuar se vepra penale është konsumuar në territorin administrativ që mbulohet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga aktet, gjithashtu, vërehet se të gjitha hetimet e mëtejshme nga organi i prokurorisë deri në vleftësimin e masës së sigurimit personal, por edhe paditë civile të ngritura nga denoncuesi kanë vijuar në qytetin e Tiranës.

✓ Në analizë për sa më sipër nuk konstatohen problematika apo *indicie* që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

⁴⁸Denoncim nr. ***prot., datë 6.2.2019.

⁴⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 17.9.2020.

⁵⁰Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2020.

⁵¹Denoncimi nr. ***, datë 26.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 7.3.2019, përcjellë me shkresën nr. ***prot., datë 7.3.2019, e IKP-së.

4) Denoncimi⁵² i shtetasit A.H.

Denoncuesi paraqet disa sekuenca nga çështje të ndryshme penale për të cilat në mënyrë të vazhdueshme identifikon subjektin e rivlerësimit, por për asnjërin prej pretendimeve nuk ka depozituar ndonjë dokument referues me qëllim vijimin e trajtimit të denoncimit në tërësi. Ndërsa në një rast identifikon një fashikull penal të hetuar në emër të shtetasit I. L., nën akuzën “falsifikim të dokumenteve”, e përfunduar me vendim pushimi për shkak të parashkrimit dhe që sipas pretendimit të tij, vendimmarrja nga subjekti ka qenë e padrejtë.

Shtetasi denoncon: (i) çështjen penale që ka nën hetim subjekti (rasti Popesku, konflikti me pasojë vdekjen në zonën e ish-bllokut); si dhe (ii) padrejtësi të bëra nga subjekti ndaj të akuzuarit I. L. dhe më konkretisht denoncon faktin se subjekti ka kërkuar masën e arrestit me burg ndaj këtij shtetasi, megjithëse vepra për të cilën kallëzohej “falsifikim dokumentesh” të një kontrate shitjeje të kryer në vitin 2004, ishte parashkruar për shkak të kohës kur kishte ndodhur ngjarja.

Lidhur me këtë denoncim janë kërkuar fashikuj penalë në ngarkim të shtetasit I.L. . Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vënë në dispozicion dosjen hetimore në ngarkim të shtetasve K. K. dhe I. L. .

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin penal që i përket procedimit penal nr***, bashkuar me procedimin nr. ***, rezultoi si vijon:

Me vendimin e datës 27.10.2015 është vendosur pushimi i çështjes penale nr***, datë 5.2.2015, bashkuar më 9.2.2015 me procedimin penal nr. ***, datë 5.2.2015, në ngarkim të personave nën hetim K.K. dhe I. L. . Bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 261, të Kodit të Procedurës Penale – konstatimi i shuarjes së masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale të vendosur ndaj këtyre shtetasve me anë të vendimeve nr. *** akti dhe nr. *** akti, datë 6.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, etj.

Rrethanat e çështjes

Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan ka referuar materialet që bëjnë fjalë për kallëzimin e bërë nga disa banorë të Librazhdit, ndaj shtetasve K.K. dhe I. L., përkatësisht shtetasi K. K., me detyrë noter, dhe shtetasi I.L. si blerës i disa pasurive “arë” të këtyre shtetasve, me qëllim ndërtimin e hec-it “E.”. Kallëzimi është bërë nën pretendimin për *falsifikim të kontratave të shitblerjes* lidhur në maj të vitit 2004 mbi pasuritë e tyre të paluajtshme, të cilat kanë sjellë tjetërsimin në favor të shtetasit I. L., si dhe për *mashttrim* për shkak të moslikuidimit të premtuar.

Deri në këtë vendimmarrje janë konstatuar disa veprime hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit. Më konkretisht:

- i) Në datën 13.2.2015 nga subjekti është urdhëruar kryerja e disa veprimeve hetimore, ku ndër të tjera, është kërkuar të procedohet edhe me kryerjen e ekspertimit teknik – grafik të shkrimit dhe nënshkrimit të kontratave, objekt hetimi (referojuni faqes së numërtuar nr.19 në fashikull).
- ii) Në datën 5.5.2015, në lidhje me procedimin penal nr. *** është vendosur (referojuni faqes së numërtuar nr.17 në fashikull) zgjatja e afatit të hetimeve paraprake, për 3 muaj, deri më 5.8.2015, me qëllim kryerjen dhe administrimin e aktekspertimit teknik – grafik, si dhe një

⁵²Denoncim nr***, datë 7.6.2019.

tërësie veprimesh të tjera hetimore që do të rezultojnë në dinamikë nga administrimi i këtyre akteve.

iii) Nën të njëjtin arsyetim, në datën 31.7.2015n është vendosur (referojuni faqes së numërtuar nr.18, në fashikull) përsëri zgjatja e afatit të hetimeve paraprake deri më 5.11.2015.

iv) Ndër të tjera, në vendim argumentohet mbi institutin e parashkrimit të ndjekjes penale duke u cilësuar që ndjekja penale për veprat penale, objekt hetimi, nuk mund të vazhdojë për shkak të parashkrimit. Në vendim orientohen personat e interesuar për t'iu drejtuar gjykatës civile me qëllim konstatimin e pavlefshmërisë juridiko-civile të veprimeve juridike (kontratave). Gjithashtu, në vendim thuhet që kontratat objekt hetimi duhet të deklarohen të falsifikuara dhe për shkak të natyrës së tyre unike t'i kthehen ZVRPP-së me shënimin “të falsifikuara” me qëllim marrjen e masave prej këtij organi.

v) Në dosje janë administruar edhe aktekspertimet teknike-grafike, të datave 13.8.2015 dhe 29.9.2015, si dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit pranë organit gjyqësor për vleftësim të masës së arrestit “detyrim paraqitje”.

Në vendimin e pushimit nuk arsyetohet mbi zgjatjen e afatit të hetimit dhe as mbi konkluzionet e aktekspertimeve, ndërsa konkludohet për kontrata të falsifikuara dhe dërgim të tyre me këtë shënim “të falsifikuara”, në ZVRPP.

Mbi këtë konkludim, nga leximi i konkluzioneve përfundimtare të aktekspertimeve rezulton se hera-herës flitet edhe me probabilitet për sa i përket shkrimit apo nënshkrimit të kallëzuesve në kontratat e shitjes të pasurive të tyre, hartuar në vitin 2004, pra konkluzionet e ekspertimeve duket se nuk janë të prera.

Si në kërkimin e prokurorit/subjektit të rivlerësimit për vleftësimin e masës së sigurimit personal, por edhe në arsyetimin e vendimit të pushimit identifikohet që gjithë ecuria dhe rrethanat mbi të cilat është hetuar i përket akteve të nënshkruara në vitin 2004.

Është e paqartë se përse janë kryer veprime hetimore, përfshirë edhe zgjatjen e afateve, për sa kohë që: (i) kontratat objekt hetimi i përkitnin vitit 2004 dhe kallëzimet datonin në vitin 2015 (11 vjet më pas); (ii) këto akte janë depozituar që me referimin e kallëzimeve nga organi përkatës dhe nuk kanë qenë në vështirësi sigurimi; (iii) po për këto akte dhe mbi to janë shtrirë hetimet; (iv) zgjatja e afateve është bërë kryesisht me qëllim bërjen e aktekspertimeve mbi rregullsinë e këtyre kontratave; (v) asnjëra nga veprat për të cilat është bërë kallëzimi nuk parashikojnë dënim më të lartë se 10 vjet.

Në të tilla kushte, përllogaritjet për të vlerësuar lidhur me institutin e parashkrimit, duket se kanë qenë lehtësisht të mundura për t'u kryer.

Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha arsyet ligjore për të vendosur mosfillimin e procedimit.

Është e paqartë se përse subjekti në vendimin e pushimit të procedimit ka orientuar palët që t'i drejtohen gjyqësorit për pavlefshmëri të kontratave dhe për pasojat e ardhura prej tyre dhe, njëkohësisht, ka arsyetuar që kontratat t'i kthehen ZVRPP-së me shënimin “të falsifikuara” me qëllim që ky institucion të ndërmarrë veprimet ligjore.

Duket se hetimi nuk ka qenë produktiv, për më tepër kur të kallëzuarit kanë qenë gjatë gjithë kohës në masën e sigurisë “detyrim paraqitje”, për një vepër të parashkruar.

Megjithëse është arsyetuar se kontratat duhet të kthehen në ZVRPP me shënimin “të falsifikuara”, nuk kuptohet nëse subjekti ka vepruar në të njëjtën mënyrë për t'iu drejtuar edhe institucionit përkatës, i cili ka licencuar noterin (profesionin e tij), me qëllim vënien në dijeni për marrjen e masave lidhur me ushtrimin e detyrës/profesionit të lirë.

Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, të qartësojë nëse ndaj kësaj çështjeje është ushtruar e drejta e ankimit dhe cili është aktualisht statusi i saj, si dhe të depozittojë dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve.

Subjekti, në parashtrimet e tij, ka qartësuar se:

i) Konkluzionet e dhëna në vendimin e pushimit janë bazuar në konkluzionet e aktekspertimeve teknike-grafike shkrimi dhe nënshkrimi. Po ashtu, edhe disponimi për provat materiale të sekuestruara është bazuar në këto konkluzione.

ii) Nga teknika dhe metodika kriminalistike, konkluzionet e aktekspertimeve ndahen në kategorike dhe probabël. Subjekti ka pasqyruar konkludimet e secilit aktekspertimi mbi nënshkrimet e kontratave objekt hetimi, duke identifikuar për secilin akt se konkluzionet kanë qenë kategorike apo probabël dhe që probabiliteti është përfshirës.

iii) Kontratat janë shënuar të falsifikuara dhe me këtë shënim janë kthyer pranë ZVRPP-së sipas nenit 190/1/b të Kodit të Procedurës Penale.

iv) Ndërsa në lidhje me aktin kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 31.5.2004, redaktuar nga noteri K. K. në Librazhd, me palë shitëse shtetasit Sh., M., Q., S., B. dhe V. Gj. dhe palë blerëse shtetasin I.L., është urdhëruar kthimi në ZVRPP sipas nenit 190/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, pasi gjatë hetimit shtetasit B., S., Sh. dhe M.Gj. kanë pranuar që të jenë në dijeni për shitjen e tokës së tyre shtetasit I. L. për ndërtimin e një hidrocentrali, kanë pranuar se kanë nënshkruar dokumentet për këtë veprim dhe se të gjitha bisedat për shitje me shtetasin I. L. i ka kryer babai i tyre, Sh. Gj. . Këta shtetas nuk kanë pasur asnjë kontenstim për kontratën dhe veprimin e shitjes së tokës.

v) Vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve janë arsyetuar mbi shkaqet që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit për zgjatje. Këto vendime i janë njoftuar personave nën hetim, të cilët nuk kanë pasur asnjë kontenstim gjyqësor për to.

vi) E gjithë veprimtaria hetimore është kryer edhe nisur nga nevoja për të zhvilluar një procedim penal të drejtë dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave/kallëzuesve, si dhe për rikuperimin e pasojave të veprës penale.

vii) Në lidhje me konstatimin se është e paqartë se përse janë kryer veprime hetimore, përfshirë edhe zgjatje të afateve, për sa kohë që: (a) kontratat objekt hetimi i përkitnin vitit 2004 dhe kallëzimet datonin në vitin 2015 (11 vjet më pas); (b) këto akte janë depozituar që me referimin e kallëzimeve nga organi përkatës nuk kanë qenë në vështirësi sigurimi; dhe (c) po për këto akte dhe mbi to janë shtrirë hetimet; (ç) zgjatja e afateve është bërë kryesisht me qëllim bërjen e aktekspertimeve mbi rregullsinë e këtyre kontratave; (d) asnjëra nga veprat për të cilat është bërë kallëzimi nuk parashikojnë dënim më të lartë se 10 vjet. Në të tilla kushte, përllogaritjet për të vlerësuar lidhur me institutin e parashkrimit, duket se kanë qenë lehtësisht të mundura për t'u kryer dhe subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar:

“... në veprën penale ‘falsifikim të dokumenteve’, e cila është vepër penale materiale, është shumë e vështirë të konstatohet parashkrimi i ndjekjes penale sipas nenit 66 të Kodit Penal pa kryer hetime të thelluara dhe të gjithanshme. Kjo sepse vepra penale e falsifikimit të dokumenteve sipas kuptimit që jep neni 186 i Kodit Penal kryhet në dy forma të anës objektive: (1) falsifikimi i dokumenti; dhe/ose (2) përdorimi i dokumentit të falsifikuar. Pra, në rrethanat objekt hetimi, mundet që të konstatohej lehtësisht fakti që dokumentet objekt material të veprës penale ishin përpiluar të falsifikuara në vitin 2004, por ka qenë e nevojshme të hetohej përdorimi i tyre sepse ka ekzistuar mundësia potenciale që ato të ishin përdorur në një vit të mëpasshëm, brenda të cilit nuk gjente zbatim instituti i parashkrimit të ndjekjes penale. Me fjalë të tjera, një dokument mund të jetë falsifikuar në vitin 2004 dhe ndjekja penale për këtë

fakt është parashkruar, por mund të ishte përdorur në vitin 2014 dhe subjekti i veprës penale natyrisht që ka përgjegjësi penale për këtë fakt përdorimi. Për këtë arsye edhe për procedimin penal në fjalë janë zhvilluar hetime të plota dhe të gjithanshme për të hetuar në mënyrë ezauruese të gjithë elementët e figurës së krimit të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, si për sa i takon formës së falsifikimit të dokumentit, ashtu edhe në drejtim të formës së përdorimit të këtij dokumenti.

viii) Në lidhje me konstatimin se dukej se subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha arsyet ligjore për të vendosur mosfillimin e procedimit, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar:

“Instituti i mosfillimit të procedimit penal, i parashikuar në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale presupozon mosfillimin e ndjekjes penale në ato raste që parashikohen nga kjo dispozitë. Ky institut nënkupton që nga ana e organit procedues të kryhet një vlerësim i akteve paraprake të referuara/kallëzuara dhe nëse organi procedues konstaton ekzistencën e shkakut që nuk lejon fillimin e procedimit, të vendosë mosfillimin e tij. Në situatën kur nga policia gjyqësore janë kryer veprimet hetimore me iniciativë të tilla si këqyrje dhe marrje provash, pyetje personash në cilësinë e të hetuarit, marrjen e modeleve të shkrimit dhe nënshkrimit etj., si dhe për më tepër është ushtruar kompetenca e arrestimit/ndalimit të personit konkret, si dhe kontrollit personal të të ndaluarit, gjendemi përpara faktit që ndjekja penale ka filluar dhe do të ishte proceduralisht e gabuar nëse do të urdhërohej mosfillimi i procedimit, kur në fakt ndjekja penale kishte filluar, madje duke avancuar nga policia gjyqësore deri në arrestimin/ndalimin e personit konkret, pra në ushtrimin e kompetencave që drejtohen ndaj të drejtave dhe lirive personale të shtetasve. Pra ... parashtroj se nuk mund të vendoset mosfillimi i një procedimi penal në kushtet kur policia gjyqësore referon materialet hetimore me persona të arrestuar ose ndaluar sikundër ka qenë edhe rasti konkret për shtetasit L. dhe K. . Në një rast të tillë, veprimi i organit procedues është i orientuar drejt verifikimit të kushteve dhe kriterëve për vlefësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit”.

ix) Në lidhje me konstatimin se ishte e paqartë se përse subjekti në vendimin e pushimit të procedimit ka orientuar palët që t’i drejtohen gjyqësorit për pavlefshmëri të kontratave dhe pasojat e ardhura prej tyre dhe, njëkohësisht, ka arsyetuar që kontratat t’i kthehen ZVRPP-së me shënimin “të falsifikuara” me qëllim që ky institucion të ndërmarrë veprimet ligjore, subjekti ka shpjeguar:

“Për sa i takon kësaj pike, më lejoni të sqaroj se të gjitha kontratat e administruara në kuadër të këtij procedimi penal janë sekuestruar nga organi procedues, sipas vendimit të prokurorit, në zbatim të neneve 208 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Neni 190 i Kodit të Procedurës Penale detyron organin procedues që në përfundim të hetimit të shprehet mbi këto prova materiale të sekuestruara. Obsionet që vendos kjo dispozitë për organin procedues janë si vijon: provat që kanë shërbyer si mjet për kryerjen e veprës penale ose përfitim prej saj të kalojnë në favor të shtetit, sendet mbajtja ose qarkullimi i të cilave është e ndaluar iu dorëzohen enteve përkatëse ose asgjësohen, sendet pa vlerë zhduken, sendet e tjera iu kthehen personave që iu takojnë. Në rastin konkret rezulton se nisur nga konkluzionet e aktekspertimeve, mundësia e vetme procedurale për të vepruar ka qenë për të disponuar sikundër është vepruar nga ana ime si prokuror i çështjes, pra kthimi i tyre në ZVRPP, por me shënimin përkatës të aktekspertimeve teknike-grafike. Ky disponim për provat materiale ka gjetur reflektim edhe në nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale, i cili lejon gjykatën që të konstatojë falsitetin e një akti në vendimin e saj përfundimtar. Në rastin konkret, meqenëse çështja, sipas ligjit të kohës, është pushuar nga prokurori, nuk ka qenë e mundur që për këtë falsitet të shprehet gjykata por referimi im si prokuror i çështjes është bazuar në nenin 190/1/b të Kodit të Procedurës Penale. Në këto rrethana, ... arsyeja e disponimit për kalimin e provave materiale pranë ZVRPP-së me shënimet përkatëse ka qenë fakti që palët e interesuara mund të utilizonin rrugët gjyqësore

civile për konstatimin e pavlefshmërisë së një veprimi juridik (akt noterial), pasojat juridike të së cilës mund të rregulloheshin nga gjykata civile sipas neneve 92/a të Kodit Civil dhe 32/a, 36, 41, 103, 106 dhe 154 të Kodit të Procedurës Civile. Po ashtu, në referim të ligjit të kohës edhe organi administrativ, në këtë rast ZVRPP, mund të ndërmerre hapa administrative për sqarimin dhe rregullimin e situatës juridike të pronave nëpërmjet masave administrative në kartelat e pasurive të tilla si urdhër për kufizimin e veprimeve etj., sipas përcaktimeve të ligjit nr. 33/2012. Për këtë arsye dhe për këto nevoja të proceseve eventuale administrative dhe/ose gjyqësore është disponuar në atë formë nga ana ime si prokuror i çështjes. Çdo disponim i ndryshëm nga sa është kryer nga ana ime për këtë çështje do të krijonte premisa për thellim të pasojave juridike dhe të konfliktit juridik mes palëve në proces (p. sh.: kthimi i akteve në ZVRPP pa shënimin përkatës) ose do të pamundësonte provimin e ekzistencës së marrëdhënies juridike mes palëve në proceset eventuale gjyqësore dhe/ose administrative (p. sh.: asgjësimi i dokumenteve të sekuestruara)”.

x) Në lidhje me konstatimin se dukej se hetimi nuk ka qenë produktiv, për më tepër kur të kallëzuarit kanë qenë gjatë gjithë kohës në masën e sigurisë “detyrim paraqitje”, për një veprë të parashkruar, subjekti ka qartësuar me të njëjtët argumente si më sipër.

xi) Në lidhje me konstatimin se, megjithëse është arsyetuar se kontratat duhet të kthehen në ZVRPP me shënimin “të falsifikuara”, nuk kuptohet nëse subjekti ka vepruar në të njëjtën mënyrë për t’iu drejtuar edhe institucionit përkatës, i cili ka licencuar noterin (profesionin e tij), me qëllim vënien në dijeni për marrjen e masave lidhur me ushtrimin e detyrës/profesionit të lirë, subjekti ka shpjeguar:

“Në lidhje me këtë pikë, ... sikundër e kam theksuar edhe më sipër qëllimi i dërgimit të kontratave pranë ZVRPP-së ka qenë që nga ana e këtij institucioni dhe/ose personave të interesuar të vlerësohej mundësia për rregullimin administrativ ose gjyqësor të situatave juridike të pasurive objekt kontraktor. Ndërsa për sa i takon noterit nuk është vënë në dijeni institucioni përkatës për shkak se në referim të nenit 8 të ligjit të kohës, pra, ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 (i ndryshuar) ‘Për noterinë’ masat disiplinore ndaj një noteri nuk mund të jepeshin nëse kishte kaluar më shumë se 3 vjet nga kryerja e tyre”.

xii) Në lidhje me ushtrimin e të drejtës së ankimit mbi këtë çështje, si dhe mbi statusin aktual të saj, subjekti ka qartësuar:

Ndaj vendimit datë 27.10.2015 për pushimin e procedimit penal nr. *** ka ushtruar ankim shtetasi I. L. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 21.4.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 12.6.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës.

xii) Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 21.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, arsyeton si vijon:

Në tërësi, subjekti ka dhënë shpjegime për çdo konstatim duke sqaruar se ka arsyetuar në vendimmarrjen e tij gjithë ecurinë e çështjes penale. Gjithashtu, subjekti ka analizuar ligjërisht mbi të gjitha hapat procedurale të ndërmarra në hetim, si dhe në kryerjen e veprimeve hetimore, përfshirë këtu këqyrjen dhe marrjet e provave dokumentare, si dhe aktekspertimet teknike-grafike të dokumenteve “kontratë shitblerje”. Subjekti, në drejtim të zgjatjes së hetimeve dhe konkludimit për zbatueshmërinë e institutit të parashkrimit, ka shpjeguar se *në rrethanat objekt hetimi, mundet që të konstatohej lehtësisht fakti që dokumentet objekt material i veprës penale ishin përpiluar të falsifikuara në vitin 2004, por ka qenë e nevojshme të hetohej përdorimi i tyre (pra nëse ishin përdorur në të njëjtin vit apo më pas), sepse ka ekzistuar mundësia*

potenciale që ato të ishin përdorur në një vit të mëpasshëm, brenda të cilit nuk gjente zbatim instituti i parashkrimit të ndjekjes penale.

Trupi gjykues, qëndrimin e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ, e ka vlerësuar në raport me analizën e arsytimit të vendimit të pushimit të saj, mbi veprimet hetimore të ndërmarra në këtë çështje.

Në këtë kontekst, lidhur me provueshmërinë e institutit të parashkrimit, ku edhe duket se është situata thelbësore e kësaj çështjeje, konstatohet se edhe duke qëndruar në logjikën e subjektit, të gjitha procesverbalet e këqyrjes dhe marrjes së provës dokumentare (praktikat e pasurive të shitura), pranë ZVRPP-së Librazhd, nga ana e policisë gjyqësore, datojnë në datën 27.1.2015 dhe 4.2.2015, pra, përpara regjistrimit të procedimeve penale. Po në referim të arsytimit të vendimit të subjektit, është shkruar për secilën praktikë të pasurive se aplikimet për regjistrim të tyre janë bërë nga blerësi i pronës, shtetasi I.L. (i kallëzuar) që prej vitit 2004, pra në kohën e realizimit të kontratave të shitjes së pasurive. Në këtë këndvështrim, duket se përveç se koha e nënshkrimit të kontratave ishte evidente që në regjistrimin e procedimit, po ashtu evidente ishte edhe koha e përdorimit të tyre për shkak se aplikimi i tjetërsimit të pasurive ishte bërë po në vitin 2004.

Gjithashtu, konstatohet se çdo zgjatje e hetimeve paraprake ka qenë thjesht dhe vetëm për të kryer dhe administruar aktet përkatëse të ekspertimit teknik – grafik (sikurse citohet edhe në arsytimin e vendimeve të zgjatjes së hetimeve), pra jo në kuadër të ndonjë hetimi lidhur me verifikimin e kohës së përdorimit të kontratave të shitjes së pasurive.

Nën këtë arsytim duket se nuk qëndron pretendimi i subjektit se ishte i nevojshëm hetimi i përdorimit të akteve të falsifikuara (kontratë shitjeje) kur ai ka qenë lehtësisht i verifikueshëm.

Në këtë kuptim, nëse nuk mund të vendosej mosfillimi, sikurse qartëson subjekti, për shkak se ndjekja penale kishte nisur dhe madje hetimet kishin avancuar nga policia gjyqësore, duket se mund të konkludohej brenda afatit të parë ligjor nga regjistrimi i procedimit, lidhur me institutin e parashkrimit, pasi falsifikimi i pretenduar dhe përdorimi kishin datuar bashkë në një vit, pra në vitin 2004. Në këtë logjikë arsytimi, edhe masa e sigurimit personal ndaj të kallëzuarve do të ishte shuar.

Në tërësi, për sa është arsytuar, trupi gjykues konstaton mangësi mbi këtë çështje, pasi nuk janë kryer veprime hetimore lidhur me përdorimin e akteve noteriale dhe, për pasojë, duket se ka qenë e panevojshme zgjatja e afateve të hetimit, si dhe vijueshmëria e masës së sigurimit personal ndaj të akuzuarve.

5) Denoncim⁵³ i shtetasit M. H., adresuar nga Komisioneri Publik

Denoncuesi, në denoncimin e tij, synon të hedhë dritë nëpërmjet disa pretendimeve për veprime të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit në hetimin e disa çështjeve penale. Denoncuesi kërkon që të verifikohen shkeljet e kryera nga subjekti.

Lidhur me një aferë korruptive me shtetasin H.B. (avokat) që sipas denoncuesit nuk arriti të përfundohej nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me këtë denoncim Komisioni ftoi për dëgjuesë shtetasin H.B. . Në tërësi të komunikimit pyetje përgjigje, ky shtetas tregoi se kishte pasur njohje të pakta thujse aspak me subjektin e rivlerësimit, kryesisht nëpër ambiente të gjykatës kur secili prej tyre ushtronte detyrën e tij, përkatësisht subjekti i rivlerësimit si përfaqësues i organit të akuzës e ndërsa shtetasi H. B. si avokat, i cili kundërshtoi denoncimin lidhur me aferën korruptive duke qartësuar se as nuk kishte dijeni mbi një pretendim të tillë.

⁵³Nr. ***prot., datë 4.4.2019 përcjellë me shkresën nr. ***prot., datë 4.4.2019, e IKP-së.

Lidhur me aksidentin e kryer nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 me pasojë vdekjen e një shtetaseje, për të cilën denoncuesi thekson se aktekspertimi në dosjet e hetimit ndaj subjektit të rivlerësimit është përgatitur nga miq të babait të subjektit, pasi edhe vetë babai i subjektit (shprehur denoncuesi) ka qenë ekspert auto-teknik në Ministrinë e Brendshme. Gjithashtu, denoncuesi parashtron se në këtë rast subjekti, së bashku me një tjetër prokuror, kanë paguar për mbylljen e këtij procesi penal.

Për këtë çështje Komisioni⁵⁴ ka administruar fashikullin penal nr. *** i regjistruar fillimisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku dhe ka ndodhur aksidenti dhe ku njëkohësisht, në atë kohë, subjekti ushtronte detyrën po në këtë prokurori. Për këtë shkak, dosja është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier. Në përfundim të hetimit është vendosur pushimi i procedimit penal me arsyetimin se në tërësi nga studimi i akteve të procedimit penal nr***, datë 11.7.2011, rezulton se mungon ana objektive e veprës penale e parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, pasi të dy aktekspertimet auto-teknike, në harmoni edhe me provat e tjera, kanë arritur në konkluzion se shkak i aksidentit është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e këmbësorës (viktimit H. M.) dhe se në këto rrethana kur veprimet hetimore janë kryer të plota dhe kur nuk ka burime të tjera provash për të provuar ekzistencën e veprës penale, në vendimin e pushimit subjekti është shprehur se fakti nuk përbën vepër penale.

Akti i parë i ekspertimit auto-teknik është përgatitur nga eksperti A. M., ekspert pranë Qendrës së Studimeve të Sigurisë Rrugore, Tiranë.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se mbi ankimin e Ndërmarrjes së Pastrimit Vlorë në Bashkinë Vlorë, çështja është rihapur. Sërish është kryer aktekspertimi auto-teknik, por tashmë nga tri ekspertë, A. L., I.Q. dhe M. B. .

Pas disa hetimeve të mëtejshme, përsëri është vendosur pushimi i procedimit penal.

Nga të dhënat e administruara u vërejt se nuk mund të bëhet lidhja nëse ekspertët janë miq të babait të subjektit të rivlerësimit, pasi ata nuk pasqyrojnë asnjë marrëdhënie apo lidhje mes njëri-tjetrit apo me subjektin përgjatë këtij hetimi administrativ.

Gjithashtu, referuar po dokumentacionit të administruar por edhe informacionit të paraqitur në raportin profesional të subjektit të rivlerësimit (pasi është trajtuar edhe ky rast) rezulton se përgjatë kohës së kryerjes së hetimeve ndaj subjektit të rivlerësimit nga Prokurori i Përgjithshëm është vendosur *pezullimi nga detyra* dhe, më tej, pas përfundimit të hetimit të kësaj çështjeje dhe vendimit me formë të prerë, subjekti është rikthyer në funksionin e prokurorit.

Gjithashtu, trupi gjykues, nga administrimi i akteve në dosjen e kësaj çështjeje objekt hetimi, ka konstatuar se në referimin e veprës penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë janë saktësuar të gjithë veprimet e kryera nga grupi hetimor i ngritur për të hetuar lidhur me këtë aksident, si dhe është pasqyruar edhe fakti i shoqërimit të shtetasit A. në ambientet e policisë si personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, po edhe mbi marrjen e tij në pyetje. Njëkohësisht, po nga aktet e administruara, rezultojnë të jenë dhënë deklarime noteriale nga dy fëmijët e viktimit, të cilët deklarojnë se kanë dëgjuar se drejtuesi i automjetit ka qenë i pafajshëm dhe se nëna e tyre i ka ndërprerë rrugën.

Nën të gjithë këto fakte dhe rrethana duket se nuk konkludohet në ndonjë problematikë që të rëndojë pozitën e subjektit apo të ndikojë në vlerësimin e këtij hetimi administrativ në tërësi.

⁵⁴Me shkresën nr. ***prot., datë 21.9.2020.

Lidhur me identifikimin e disa çështjeve të tjera të hetuara nga subjekti i rivlerësimit për të cilat denoncuesi ka dhënë pak detaje, por që në tërësi pretendon se nga subjekti janë bërë shkelje, duke e akuzuar atë ndër rreshta se për secilën çështje ka marrë para.

Denoncuesi rendit çështjen që i përket dosjes hetimore në ngarkim të gjyqtarit P. A., dosjes hetimore në ngarkim të shtetasit D.B., ish-kryetar Bashkie në Gramsh, dosjes hetimore me të dëmtuar “Union Bank” për të cilën sqaron se subjekti është hetuar për shkeljet e kryera nga organi i prokurorisë në Tiranë, si edhe dosjeve që i përkasin KEMPI-t Elbasan, pedagogëve të Elbasanit që i merrnin para studentëve⁵⁵.

Komisioni, pas administrimit të dosjeve hetimore⁵⁶ dhe analizimit të akteve të administruara në to, konkludoi si vijon:

a) Në lidhje me veprimet hetimore në fashikullin penal që i përket vendimit “Për pushimin e çështjes⁵⁷ penale” që i përket procedimit nr. ***”, datë 18.1.2016

Ky procedim është regjistruar për veprat penale “refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram” dhe “pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal.

Rrethanat e çështjes

Procedimi është regjistruar mbi bazë të kallëzimit penal të bërë nga ILDKPKI-ja⁵⁸ për shtetasin P. A. me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Subjekti, në datën 15.6.2015, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, si dhe ka urdhëruar OPGJ-në, për kryerjen e disa veprimeve hetimore deri më 30.7.2015.

Në datën 26.6.2015 i është kërkuar informacion ZQRPP-së lidhur me pasuri të paluajtshme në emër të të kallëzuarit dhe familjarëve të tij.

Në datën 14.7.2015 ZVRPP-ja Sarandë ka bërë konfirmimin përkatës për një banesë në emër të të kallëzuarit.

Në datën 21.7.2015 ka konfirmuar edhe ZVRPP-ja Tiranë dhe, më tej, në data të ndryshme edhe ZVRPP të tjera.

Në datën 26.6.2015 i është kërkuar informacion edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, DPPParave, Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, Bashkisë Sarandë, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Zyrës Qendrore Kombëtare, Interpol –Tirana, QKB-së, QKL-së, DPT-së, shoqërisë “***” sh.p.k., Delvinë, shoqërisë “***”, ShRSF, Delvinë; Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit, DPSHTRR-së; etj., si dhe Bankës së Shqipërisë dhe atyre të nivelit të dytë.

Në datën 11.9.2015 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka dhënë informacionin përkatës dhe DPPParave ka kthyer përgjigje më 21.7.2015.

Në datën 29.9.2015 është vendosur kryerja e ekspertimit kontabël nga ekspert A.Q. . Aktekspertimi mban datën 12.7.2015. Në akt cilësohet se sipas opinionit të tij pasuritë e krijuara nga ky shtetas dhe shpenzimet e kryera janë të justifikuara me burimin e të ardhurave;

⁵⁵Me shkresën nr. ***prot., datë 8.6.2015.

⁵⁶Me shkresat nr. *** prot., datë 13.5.2020, nr***prot., datë 23.9.2020, nr. ***prot., datë 20.5.2020, nr. ***prot., datë 19.5.2020.

⁵⁷Dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr***prot., datë 19.5.2020.

⁵⁸Me shkresën nr***prot., datë 8.6.2015.

Në shtator të vitit 2015 është kryer ekspertimi teknik vlerësues i banesës së shtetasit A. nga eksperte E.K. .

Subjekti ka përmbyllur këtë çështje me vendimin e pushimit, datë 18.1.2016, me arsyetimin se “... ky procedim nuk mund të vazhdohet, pasi me gjithë hetimet e kryera nuk u bë e mundur të provohet se faktet objekt hetimi përbëjnë veprë penale të parashikuar nga nenet 287 dhe 257/a/2 të Kodit Penal për shkak të mosplotësimit të elementëve objektiv dhe subjektiv të këtyre veprave penale”.

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, ka vërejtur se janë kryer veprimet hetimore të cilësuar nga subjekti i rivlerësimit në vendimmarrjet e tij përkatëse, janë administruar korrespondencat e mbajtura me institucionet për llogari të hetimit të kryer, si dhe janë kryer njoftimet e akteve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues vlerësoi se përtej kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara dhe realizuara, për të cilat nuk evidentoi shkelje në adresë të subjektit të rivlerësimit, veprime të tjera të cilat mund të lidhen me themelin e çështjes dalin jashtë sferës së veprimtarisë së Komisionit, gjithnjë në kuadër të rivlerësimit të subjektit.

b) Në lidhje me veprimet hetimore në fashikullin penal që i përket vendimit “Për pushimin e çështjes penale ndaj procedimit penal nr. ***”

Nga aktet e administruara ka rezultuar si vijon:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal për veprat penale “refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga nenet 257/a/2, 244 dhe 248 të Kodit Penal.

Organi i akuzës është vënë në lëvizje bazuar në materialin kallëzues nr. *** prot., datë 13.2.2015, të ILDKPKI-së, në ngarkim të shtetasit D. B.(me funksion kryetar i Bashkisë Gramsh), material i përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2015, të Drejtorisë Task-Forcë.

ILDKPKI-ja ka analizuar dokumentacionin e administruar nga shtetasi D. B. në deklaramin e interesave private të tij për vitet 2003, 2004,2011,2012 dhe 2013.

Në tërësi, nga materiali kallëzues i ILDKPKI-së, janë evidentuar mosdeklarimet e subjektit të deklaramit D. B. në ILDKPKI, në deklaramtën e interesave private “Pas largimit nga funksioni viti 2003” të dy shtëpive në proces legalizimi, për të cilat ka depozituar formularët e aplikimit në procesin e legalizimit përkatësisht në vitin 1997 dhe 2001; për mosprovueshmëri të burimit të krijimit të pasurive, ku është përfshirë edhe deklarami i një automjeti tip “Fuoristradë TYOTA”, në shumën 12.483.000 lekë. Po ashtu, materiali kallëzues ka paraqitur edhe problematikat e diktuar për këtë subjekt deklarami për vitet 2011, 2012 dhe 2013 për disa të ardhura të padeklaruara dhe transaksione të kryera nga bashkëshortja e shtetasit D.B., gjithashtu të padeklaruara. Në përfundim, ILDKPKI-ja, në materialin kallëzues vë në dukje se në datën 21.1.2015, shtetasi D.B. ka tentuar dhënien e një sasive parash *cash* në ambientet e sallës së ILDKPKI-së, inspektorëve të ngarkuar për kontrollin e plotë me qëllim mbylljen e problemeve të konstatuara.

Në datën 25.2.2015 është urdhëruar kryerja e disa veprimeve hetimore deri më 15.4.2015 lidhur me procedimin penal ndaj shtetasit D.B., duke përfshirë këtu edhe kërkimin e informacionit pranë ILDKPKI-së për tentativën e dhënies së të hollave nëpunësve të këtij institucioni, si dhe marrjen e tyre në pyetje.

Në datën 26.7.2016 janë urdhëruar të tjera veprime hetimore për t'u kryer brenda datës 10.9.2016.

Në datën 23.10.2016 Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, i cili kishte urdhëruar kryerjen e hetimeve të tjera në datën 26.7.2016 me subjektin e rivlerësimit Kreshnik Ajazi.

Nga aktet e administruara duket se kryesisht veprimet hetimore janë kryer përpara datës 26.7.2016, pra, përpara kohës kur është caktuar për vijueshmërinë e hetimeve, subjekti i rivlerësimit.

Nga aktet u konstatua si vijon:

Në vendimin e pushimit të çështjes citohet se me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2016, është kërkuar të paraqiten inspektorët e ILDKPKI-së me qëllim ballafaqimin me shtetasin D. B., pasi ky i fundit ka pretenduar se në deklarin e tij në ILDKPKI nuk ka qenë njëri prej inspektorëve dhe se ky veprim procedural nuk është kryer pasi të dy inspektorët nuk janë paraqitur.

Në procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, datë 16.3.2016, rezulton se janë marrë në pyetje inspektorët F.B. dhe A. B., të cilët kanë mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me shtetasin D. B., për dhënie të parave në përfundim të deklarimeve të tij mbi kontrollin e plotë, në ambientet e institucionit të ILDKPKI-së.

Me vendimin e datës 1.2.2016 është caktuar eksperti, të cilit edhe i janë konkretizuar detyrat përkatëse.

Në tërësi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar pas relacionit të OPGJ-së, ku dhe sugjerohet pushimi i çështjes, por edhe pas të gjitha veprimeve hetimore, të cilat ishin urdhëruar për t'u kryer nga subjekte të tjerë të rivlerësimit dhe jo nga subjekti i rivlerësimit.

Megjithatë, për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të qartësojë nëse ndaj vendimit të pushimit është ushtruar ankim, si dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës.

Subjekti ka konfirmuar se ndaj vendimit të pushimit datë 27.12.2016 që i përket procedimit nr. *** nuk është paraqitur asnjë ankim dhe për të provuar këtë fakt ka depozituar shkresën vërtetimin nr. *** prot., datë 17.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Për sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të të gjithë dokumentacionit të administruar dhe së fundi edhe konfirmimit të statusit ligjor të çështjes, nuk konstatoi problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

c) Në lidhje me veprimet hetimore në fashikullin penal që i përket vendimit “Për pushimin e çështjes penale ndaj procedimit nr***.

Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore me kërkues shoqëria “Union Bank”, person i interesuar shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “kundërshtim i vendimit datë 31.12.2014, për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Ndërsa nga aktet në fashikullin hetimor ka rezultuar se me vendimin datë 31.12.2014, Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur “Pushimin e çështjes penale” ndaj procedimit penal nr. ***, viti 2014.

Kjo çështje është trajtuar edhe në raportin e vlerësimit profesional⁵⁹. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni kanë rezultuar të njëjtat fakte. Më konkretisht:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, më 28.12.2017, Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan D. G., kryesisht ka vendosur të regjistrojë procedimin penal nr***, për

⁵⁹ në seksionin e kallëzimeve të adresuara ndaj subjektit të rivlerësimit

veprat penale “shpërdorim të detyrës” dhe “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186/3 të Kodit Penal, si edhe emrin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, Kreshnik Ajazi.

Në datën 28.12.2017, Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi subjekti i rivlerësimit ishte me detyrë prokuror në Prokurorinë Elbasan.

Në datën 10.1.2018, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2018, për veprat penale “shpërdorim të detyrës” dhe “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186/3 të Kodit Penal.

Nga hetimi ka rezultuar se Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, prokurori D. G., ka regjistruar kryesisht çështjen penale dhe ka filluar hetimet në ngarkim të prokurorit Kreshnik Ajazi për kryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin për sa i takon administrimit të vendimit nr. ***, datë 20.2.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës. Me anë të këtij vendimi Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit dhe ka urdhëruar për rifillimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2014, të regjistruar në Prokurorinë Elbasan. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë, prokurori Kreshnik Ajazi ka marrë në dorëzim vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës dhe nuk e ka dorëzuar atë me qëllim që të mos rifillonin hetimet. Në procesverbalin e dorëzimit të materialeve të datës 13.4.2017 ka pasqyruar fiktivisht një vendim tjetër gjyqësor, të ndryshëm nga ai që lidhet me procedimin penal nr. ***, viti 2014. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë, prokurori Kreshnik Ajazi i ka kryer me dashje këto veprime, duke shpërdoruar detyrën dhe se në procesverbalin e dorëzimit të materialeve në vend të vendimit nr. ***, datë 8.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka dorëzuar vendimin nr. ***, datë 17.3.2017, me objekt asgjësim përgjimesh, duke sjellë për pasojë një dëm për hetimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014, në lidhje me cenimin e afateve hetimore.

Në lidhje me procedimin penal nr. ***, të datës 17.3.2014, rezulton se në datën 19.9.2014, nga prokurori Kreshnik Ajazi është bërë kërkesa për dërgimin për gjykim për veprën penale “mashtrim me kredi”. Drejtuesi i Prokurorisë së kohës ka shfuqizuar vendimin e dërgimit për gjykim dhe më pas është vendosur pushimi i procedimit penal. Nga “Union Bank” është bërë ankim kundër vendimit të pushimit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të pushimit, ndërsa Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur pranimin e kërkesës dhe kthimin e procedimit për vazhdimin e hetimeve. Me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2017, Prokuroria e Apelit Durrës ka dërguar vendimin e Gjykatës së Apelit. Në regjistrin e sekretarisë është shënimi “lënë në zyrë” prokurorit Kreshnik Ajazi. Me urdhrin nr. 2, datë 6.2.2017, të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan prokurori Kreshnik Ajazi ka lëvizur nga sektori i Njësisë Task-Forcë në sektorin e të miturve po në këtë prokurori.

Prokuroria Tiranë, pas kryerjes së veprimeve hetimore, ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë elementë të veprave penale “shpërdorim të detyrës” dhe “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186/3 të Kodit Penal.

Në datën 4.4.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas përfundimit të hetimeve, ka paraqitur kërkesë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pushimin e procedimit penal nr***, viti 2018.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr***, datë 2.5.2018, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2018. Vendimi ka marrë formë të prerë më 17.5.2018, pa u ankimuar.

Për sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, veprimeve hetimore të kryera, ecurisë së gjithë procesit të kësaj çështjeje, përfshirë edhe statusin e saj përfundimtar i cili nuk ka cenuar pozitën e subjektit të rivlerësimit për faktin se

çështja është trajtuar deri edhe në organet e gjyqësorit, konkludon se nuk diktohen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

d) Në lidhje me veprimet hetimore në fashikullin penal që i përket vendimit “Për pushimin e çështjes⁶⁰ penale nr. ***”

Komisioni ka administruar fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. ***, mbi kallëzimin nr***, për korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike.

Procedimi penal është regjistruar më 9.11.2015, nga referimi i veprës penale nga Drejtoria e Policisë Vendore Elbasan, referuar kësaj të fundit nga Drejtoria për Krimin Ekonomik dhe Financiar në DPPShtetit Tiranë. Kallëzimi ka pasur si bazë ankesën e parashtruar në portalin *online* antikorrupsion sipas së cilës shtetasja Y. M., me detyrë pedagoge pranë universitetit “***”, në Elbasan, është përfshirë në veprimtari korruptive në dhënien e notave kaluese në provime dhe në procedurat e mbrojtjes së diplomave, duke kërkuar shuma konkrete të hollash për temë diplome⁶¹. Sipas të dhënave të policisë⁶², kjo shtetase përdor si sekser të saj shtetasin S. T. .

Në datën 26.10.2015, OPGj-ja i ka referuar prokurorit të Rrethit Gjyqësor Elbasan se është vënë në dijeni për veprat penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “ushttrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga nenet 244, 259 e 245/1 të Kodit Penal.

Në datën 27.10.2015 Drejtuesi i organit të Prokurorisë Elbasan, pasi është njohur me materialin nr. *** prot., datë 27.10.2015, të shërbimeve të policisë gjyqësore në DPVendore Elbasan, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal të këtij materiali për veprat penale të parashikuara nga neni/et 244, 245 dhe 259 i/të Kodit Penal. Po në këtë urdhër është caktuar për zgjidhjen e këtij materiali subjekti i rivlerësimit.

Në datën 27.10.2015 është mbajtur procesverbal për sistemin e hyrje-daljeve nga Republika e Shqipërisë për shtetasin S. S., nga ku ka rezultuar se ky shtetas është futur në territorin shqiptar në datën 4.10.2015.

Më 9.11.2015 është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit. konkretisht:

- Sugjerimi te prokurori i lejimit të metodave speciale të hetimit me qëllim hetimin dhe provimin e veprimtarisë kriminale, nga subjektet e dyshuara. Mbajtja parasysh e referimit për lejimin e vëzhgimit/përgjimit ambiantal për kryerjen e veprimeve simuluese, si dhe për aplikimin e mjeteve të tjera për kërkimin e provës.
- Kryerja e veprimeve hetimore për gjetjen e burimeve të reja të provës për gjetjen e personave të aftë të bashkëpunojnë me organet e hetimit për këtë veprimtari, si dhe për gjetjen e çdo të dhëne apo *indicieje* tjetër që lidhet me veprimtarinë kriminale të subjekteve të dyshuara, duke i kthyer nga të dhëna operative në prova të vlefshme sipas kuptimit procedural të tyre.
- Kryerja e veprimeve të tjera hetimore të nevojshme për hetimin e çështjes dhe në çdo rast të komunikohet me prokurorin për ndonjë fakt të ri që rezulton gjatë hetimeve.
- Administrimi në dosje i akteve përkatëse.

⁶⁰Dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2020.

⁶¹Thuhet në informacionin datë 26.10.2015, për referimin e veprës penale te prokurori, f. nr. 11 e fashikullit.

⁶²Thuhet në urdhrin datë 9.11.2015, për regjistrimin e procedimit penal.

Në datën 10.11.2015 Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan i është dërguar urdhri i prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore.

Në datën 26.4.2016 (konceptuar nga subjekti i rivlerësimit) Drejtorisë së Policisë Vendore Elbasan i është dërguar nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan vendimi për kryerjen e veprimeve hetimore, si dhe aktet e procedimit penal. Po në këtë datë është bërë dhe njoftuar me këtë vendim edhe zëvendësimi i OPGJ-së z. K. Zh. me z. E.V. .

Në datën 8.6.2016 nga OPGJ-ja është këqyrrur dhe marrë nga sistemi *TIMS* raporti i shtetases Y. P. .

Në datën 8.6.2016 subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan lejimin e përgjimeve të komunikimeve telefonike për një periudhë 15-ditore, duke u përcaktuar edhe numri i telefonit të shtetases M. (P.), 06... ***. Pas kësaj kërkesë është miratuar edhe vendimi nr. **, datë 9.6.2016, për lejimin e përgjimeve të komunikimeve telefonike për këtë procedim penal, me afat deri më 24.6.2016.

Në datën 22.6.2016 subjekti i rivlerësimit ka kërkuar zgjatjen e afatit të përgjimit të komunikimeve telefonike të kësaj shtetaseje me 20 ditë, nën arsyetimin se nga përgjimet kanë dalë të dhëna në lidhje me fakte objekt hetimi.

Me vendimin nr. **, datë 24.6.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur zgjatjen e afatit të përgjimit të komunikimeve telefonike për një periudhë 20-ditore, deri më 14.7.2016.

Në datën 20.7.2016 janë dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan materialet e përgjimit (të nivelit sekret hetimor).

Në datën 29.7.2016, nga subjekti i rivlerësimit është urdhëruar transkriptimi i CD-së me materialet e regjistrimit të komunikimeve telefonike që lidhen me këtë procedim deri më 15.8.2016.

Në datën 21.9.2016, Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan i ka dërguar organit të prokurorisë procedimin penal së bashku me veprimet hetimore të kryera.

Në datën 20.9.2016, nga OPGJ-ja është relatuar⁶³ te subjekti i rivlerësimit mbi përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. **, të vitit 2015, ku ndër të tjera informohet se është mbajtur procesverbal lidhur me ecurinë e përgjimeve dhe se në analizë të faktit të hetuar nuk është provuar ekzistenca e veprës penale në veprimet e personit të dyshuar Y. P. dhe nuk është vërtetuar ekzistenca e asnjë prej formave objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe as mundësia e ndikimit në sjelljen e funksionarit publik, si dhe nuk kanë rezultuar komunikime me ndonjë shtetas të quajtur S. . Në këto kushte është sugjeruar pushimi i procedimit penal. Çështja është pushuar me vendimin⁶⁴ e pushimit datë 21.9.2016.

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të qartësojë nëse ndaj vendimit të pushimit është ushtruar ankim, si dhe të depozitohë dokumentacionin mbështetës.

Subjekti ka konfirmuar se ndaj vendimit të pushimit datë 21.9.2016, që i përket procedimit nr. *** nuk është paraqitur asnjë ankim dhe për këtë ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 17.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Për sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të të gjithë dokumentacionit të administruar dhe së fundi edhe konfirmimit të statusit ligjor të çështjes, nuk konstatoi problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

dh) Në lidhje me veprimet hetimore në fashikullin penal që i përket procedimit nr. ***

⁶³Shihni f. numërtuar 37 dhe 38.

⁶⁴I depozituar i plotë me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2021, të Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Nga aktet e administruara në dosje rezulton se Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2013, ka kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, anëtarët e Komisionit Mjekësor (KMCAP) Elbasan, si dhe administratoren e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale në Komunën L. . Në tërësi, kallëzimi ka përcjellë shkelje nga të kallëzuarit lidhur me mangësitë e konstatuara gjatë kontrollit në dokumentacionin e përfituesve të pagesës për aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit të fushë. Në këto kushte është pretenduar për përfitime të pagesave në kundërshtim me legjislacionin e fushës.

Kallëzimi është shoqëruar edhe me raportet e kontrollit, procesverbalet e mbajtura, si dhe fotokopjet e dokumenteve mjekësore.

Më tej është bërë regjistrimi i procedimit penal me nr. *** (pa cilësuar emra). Janë kryer disa veprime hetimore, ndër të cilat janë kërkuar në vijim nga ISSH-ja Elbasan informacione për përfitime të pagesave të ndryshme nga disa persona.

Gjithashtu, janë mbajtur disa procesverbale për marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale, për marrjen e modeleve të shkrimit janë administruar dosje mjekësore të personave, etj.

Në përfundim të hetimeve, çështja është pushuar me vendimin datë 9.11.2016.

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të qartësojë nëse ndaj vendimit të pushimit është ushtruar ankim, si dhe të depozitohë dokumentacionin mbështetës.

Subjekti ka konfirmuar se ndaj vendimit të pushimit datë 9.11.2016, që i përket procedimit nr. ***, nuk është paraqitur asnjë ankim dhe për këtë ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 17.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Trupi gjyqësor, në analizë të të gjithë dokumentacionit të administruar dhe së fundi edhe konfirmimit të statusit ligjor të çështjes, nuk konstatoi problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

6) Denoncim⁶⁵ i qytetarit dixhital (çështja më poshtë është denoncuar njëkohësisht edhe nga shtetasi M. H.)

Denoncimi i referohet aksidentit që ka kryer subjekti i rivlerësimit me pasojë vdekjen. Çështja penale është trajtuar më sipër po në këtë seksion.

7) Denoncim⁶⁶ i shtetasit K.K.

Denoncuesi, në ankimin e tij, ka kërkuar që të administrohet dosja e gjykuar në ngarkim të të dënuarit D. D. me pretendimin se subjekti i rivlerësimit si përfaqësues i organit të akuzës ka vepruar në kundërshtim me ligjin në vendimmarrjen e gjykatës ndaj të pandehurit D.D. pasi ka kërkuar në përfundim fillimin e vuajtjes së dënimit nga data 7.8.2009 dhe jo nga data 23.7.2014, kur duhet të fillonte, pasi kjo ishte data e vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për një vepër penale të re të kryer nga i pandehuri, veç bashkimit të dënimeve të para që kishte pasur. Denoncuesi pretendon se prokurori nuk ka bërë ankim ndaj këtij vendimi gjyqësor, duke e bërë pozitën e tij shumë të rrezikshme sepse nuk kontrollohet vendimmarrja e gjykatës nga një gjykatë më e lartë. Prokurori Kreshnik Ajazi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore për këtë çështje, në kundërshtim me ligjet penale.

Komisioni ka administruar vendimin nr. ***, datë 11.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe urdhërezekutimin për vendimin penal.

Nga verifikimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet si vijon:

⁶⁵Denoncim nr. ***prot., datë 29.5.2020.

⁶⁶Denoncim nr*** prot., datë 14.9.2020 edhe me e-mail datë 12.9.2020.

I dënuari D. D. ka vënë në lëvizje gjykatën duke kërkuar bashkimin e vendimit penal me nr. *** Akti, të datës 17.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 8.2.2019, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, bazuar në nenet 470, 471, 475 të Kodit të Procedurës Penale dhe në nenet 55 dhe 56 të Kodit Penal.

Nga arsyetimi i vendimit rezulton se me vendimin nr. *** akti, datë 17.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i pandehuri D. D. është dënuar me 23 vjet burgim dhe me vendimin nr. ***, datë 8.2.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është dënuar me 25 vjet burgim.

Organi i akuzës në këtë proces penal është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka kërkuar *bashkimin e dënimeve me 23 vjet burgim dhe 25 vjet burgim në dënimin përfundimtar prej 25 vjetësh burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga arrestimi në flagrancë i tij, datë 7.8.2009 dhe koha e mbetur pavuajtur e dënimit prej 25 vjetësh burgim, të bashkuar në një dënim të vetëm të mbahet në konsideratë dinamika e vuajtjes së dënimit të IEVP Peqin të datës 27.12.2019.*

Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 26.5.2020. Për këtë vendim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka nxjerrë urdhër ekzekutimin datë 17.7.2020.

Në kushtet kur vendimi ka marrë formë të prerë pretendimet e denoncuesit mbeten në të njëjtin nivel edhe për faktin se ato kryesisht duken se i përkasin themelit të çështjes dhe jo ndonjë shkeljeje të natyrës procedurale me tendencë zvarritje të procesit, shkelje e të drejtave të palëve për një proces të rregullt ligjor, etj. Pretendimet për shkelje që i përkasin themelit të çështjes ezaurohen vetëm në shkallë më të lartë hierarkie/gjyqësore. Në të tilla kushte, duket se nuk diktohen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

Për sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se pretendimet e denoncuesit lidhur me themelin e çështjes dalin jashtë kompetencës së tij, ndërsa i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me përfaqësimin e tij/të organit të akuzës në këtë çështje, në raport me parashikimin ligjor të bërë në nenin 469⁶⁷ të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti, lidhur me këtë çështje, ka qartësuar si vijon:

Shqyrtimi gjyqësor i kërkesës së të dënuarit për bashkimin e dënimeve është bazuar në nenet 470, 471 dhe 475 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave:

Neni 470: *“Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij”.*

Neni 471: *“Gjykata procedon me kërkesën e prokurorit, të interesuarit ose të mbrojtësit ...”.*

Neni 475: *“Në rastin e disa vendimeve, të dhëna në procedime të ndryshme kundër të njëjtit person, i dënuari ose prokurori mund të kërkojnë nga gjykata zbatimin e rregullave për bashkimin e dënimeve”.*

Në këtë kuptim, ka shpjeguar subjekti, në rastet kur gjykata e cila jep vendimin e fundit (neni 469 i Kodit të Procedurës Penale) për arsye të ndryshme procedurale të tilla si: mungesa e kërkesës nga pala, mungesë dokumentacioni etj., nuk disponon me bashkimin e dënimeve në një të vetëm sipas rregullave për bashkimin e dënimeve kur i dënuari rezulton disa herë i dënuar, ligjvënësi e ka zgjidhur këtë çështje duke i dhënë juridiksion dhe kompetencë gjykatës së vendit të ekzekutimit. Kërkesa për bashkimin e dënimeve është kërkesë në fazë ekzekutimi sipas përcaktimit që japin dispozitat e Kreut II, Titulli IX i Kodit të Procedurës Penale. Nga

⁶⁷Neni 469/Ekzekutimi i disa dënimeve /1. Kur i njëjti person është dënuar me disa vendime për vepra penale të ndryshme, prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin e fundit i kërkon gjykatës që të caktojë dënimin që duhet të ekzekutohet, duke respektuar normat mbi bashkimin e dënimeve.

ana tjetër, meqenëse i dënuari kërkues në këtë çështje ka qenë duke vuajtur dënimin në IEVP-në Peqin, gjykata e vendit të ekzekutimit sipas përcaktimit që jep neni 470 i Kodit të Procedurës Penale ka qenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pra, pjesëmarrja në këtë gjykim dhe shqyrtimi gjyqësor është bazuar në përcaktimet e neneve 470, 471 dhe 475 të Kodit të Procedurës Penale, që japin juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës së vendit të ekzekutimit për bashkimin e dënimeve. Kjo është një praktikë e konsoliduar e jurisprudencës sonë. Për ilustrim subjekti ka depozituar disa vendime të ngjashme dhe konkretisht, vendimet nr. ***, datë 14.5.2021 dhe nr. ***, datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Trupi gjykues, në analizë të rrethanave të renditura më sipër, arsyeton se juridiksioni i gjykimit të çështjes është atribut i gjykatës dhe që në këtë rast kjo e fundit e ka ligjëruar kompetencën e shqyrtimit të çështjes, duke e lidhur vendimmarrjen ngushtësisht me vendin ku i dënuari vuan dënimin, që në rastin konkret ky i fundit vuante dënimin në institucionin e vuajtjes së dënimit në Peqin, Elbasan. Në kushte të tilla nuk evidentohet ndonjë problematikë që mund të ndikojë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Gjithashtu, ky denoncues ka kërkuar të verifikohet rasti i shtetasit P.A., si dhe rasti i aksidentit të kryer nga subjekti, çështje për të cilat Komisioni hetoi dhe i ka trajtuar më sipër, në këtë vendimmarrje.

8) Denoncim⁶⁸ i shtetasit A. B.

Denoncuesi pretendon për shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit si përfaqësues i organit të akuzës në çështjen D. . Këtë çështje, Komisioni e ka trajtuar më sipër në denoncimin me nr. ***.

9) Denoncim⁶⁹ i shtetasit A. O.

Denoncuesi ankohet për veprime të padrejta (ai citon ekzaktesisht se në muajin gusht i vjen një telefonatë kërcënuese) të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mënyrën se si është thirrur në organin e akuzës, sikur ndaj tij kishte pasur fletëthirrje për t'u paraqitur dhe se nuk ishte paraqitur. Në tërësi ankohet se është akuzuar me të padrejtë. Denoncuesi qartëson se incidenti mbi një histori aksidentale të ndodhur kohë më parë, të përshkruar prej tij se kishte ndodhur me automjetin me të cilin udhëtonte me disa miq të tij italianë ishte zgjidhur, madje citon: “... disa muaj me parë isha thirrur për të marrë autorizimin për të tërhequr makinën e aksidentuar me prokurë të miqve italianë dhe i njëjti prokuror ma dha autorizimin pasi ishte bërë edhe ekspertiza mjeko-ligjore”. Denoncuesi sqaron se pasi nuk pranoi të dakordësohej për çfarë e kishin thirrur kishte përfunduar në gjyq. Në proces gjyqësor prokurori Ajazi kishte marrë një ekspertizë private për të rrëzuar ekspertizën e shtetit, mbi të cilën kishte ndërtuar akuzën. Denoncuesi bën me dije se është dënuar dhe se ka vuajtur një pjesë të dënimit në institucionin e vuajtjes së dënimit derisa ishte miratuar amnistia.

Komisioni ka administruar fashikullin penal të përcjellë⁷⁰ nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Nga aktet e administruara konstatohet si vijon:

Shtetasi A.O. i është nënshtruar procedimit penal të regjistruar në datën 10.7.2013, pas aksidentit të kryer në datën 18.6.2013 me automjetin e tij, pas të cilit është dëmtuar rëndë shtetasja italiane Xh. R., e cila udhëtonte në këtë automjet me bashkëshortin dhe shtetasin A. O. si shofer. Në dokumente pasqyrohet se shtetasi A. O. udhëtonte me miqtë e tij italianë. Në harkun kohor prej tre muaj (10.7.2013 - 10.10.2013) rezulton se subjekti i rivlerësimit: (i) mbi

⁶⁸Me e-mail-in datë 9.10.2020.

⁶⁹Me e-mail-in datë 2.3.2021.

⁷⁰Me shkresën nr. ***prot., datë 23.4.2021.

kërkesën datë 4.7.2013 të shtetasit A.O. ka urdhëruar (po në datën 4.7.2013) kthimin e menjëhershëm të automjetit të sekuestruar (në datën 20.6.2013) për llogari të procedimit penal, si dhe të dokumenteve të tjera të automjetit, si leje qarkullimi, karton jeshil dhe leje drejtimi; (ii) ka vendosur në datën 12.9.2013, caktimin e ekspertit për kryerjen e riekspertimit dhe më tej jashtë kësaj periudhe (pasi është zgjatur afati i hetimeve paraprake deri më 10.1.2014); (iii) në datën 16.12.2013 ka vendosur marrjen si të pandehur të shtetasit A.O. dhe njëkohësisht edhe njoftimin e akuzës ndaj tij; (iv) ky shtetas është marrë në pyetje në cilësinë e të pandehurit në datën 9.1.2014 dhe po në këtë datë është sugjeruar nga OPGJ-ja që çështja penale nr. ***, viti 2013, me të pandehur shtetasin A.O. të kalojë për gjykim; (v) për këtë çështje subjekti ka referuar edhe konkluzionet përfundimtare në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të cilat ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe dënimin e tij me 12 muaj burgim sipas nenit 290/II të Kodit Penal.

Për sa më sipër, nga aktet e administruara në fashikullin penal, trupi gjykues konstatoi se personi nën hetim (denoncuesi) ka pasur dijeni për veprimet hetimore të kryera, si dhe ka nënshkruar në vendimmarrjet e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu u konstatua se veprimet procedurale janë përmbushur në kohë, përkundër asaj që pretendohet nga subjekti se nuk ka pasur dijeni. Trupi gjykues, përgjithësisht, në analizimin e kësaj çështjeje nuk evidentoi problematika, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

Arsyetimi ligjor dhe rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit

Sipas dispozitave të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se: *“Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”*.

Pika 2, e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 përcakton: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”*.

Pika 4, e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 përcakton: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”*.

Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë:

- pikën 1, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”*;

- nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *“Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”*;

- vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: *“... në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e*

vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL - AD (2016)036 të Komisionit të Venecias);

- nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, arsyetohet se:

Mangësitë e konstatuara në çështjen e numërtuar “nr. 4”, në rubrikën e trajtimit të denoncimeve, nuk janë të mjaftueshme:

- për t’i çmuar si sjellje të përgjithshme dhe të vazhdueshme të këtij prokurori;
- për ta vlerësuar subjektin me mangësi profesionale; si dhe
- për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij.

Sa më sipër, si dhe për shkak të kufizimit për të mos zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit, trupi gjykues vlerëson se vetëm mangësitë e gjetura në çështjen e trajtuar më sipër, mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor të tij, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për t’u vlerësuar më tej nga organi kompetent.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit Kreshnik Ajazi ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i njëjës prej dosjeve të hetuara nga subjekti, arsyetuar në pikën 4, është e pamjaftueshme për të arritur në vlerësimin e tij sipas germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kreshnik Ajazi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

2. Transferimin e çështjes penale që i përket vendimit të pushimit, datë 27.10.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lidhur me aktet e procedimit penal nr. ***, datë 5.2.2015, bashkuar me procedimin penal nr. ***, datë 5.2.2015, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 30.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta